

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË HIMARË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Himarë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 7, datë 30.01.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 770/20, datë 31.01.2015, i ka rekomanduar z. Jorgo Goro, Kryetar i Bashkisë Himarë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar rekomandimet e KLSH, dërguar me shkresën nr. 372/6, datë 29.3.2010, si dhe rikërkuar me shkresën nr. 372/17, datë 22.10.2010, nga ku nga **33** masa organizative të rekomanduara nuk janë zbatuar **8** masa; nga 33 masa për shpërbllim dëmi është bërë kontabilizimi për vlerën 28,947,094 lekë është nxjerr urdhri i njoftimit për 15 raste në shumën 14,689,882 lekë dhe nuk janë nxjerr urdhër njoftimi në 16 raste në shumën 14,257,212 lekë; nuk janë zbatuar 5 raste të rekomandimit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, që të ndëshkojë administrativisht duke aplikuar gjobë për 5 persona, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në cilësinë e kolaudatorit dhe në cilësinë e preventivuesit nga 50,000 lekë secili, moszbatimi e arkëtimi i këtyre masave në vlerën **19,053,367 lekë** (për 11 masa zhdehtëuese dhe 5 masa administrative) është dëm ekonomik i shkaktuar buxhetit të shtetit nga keq menaxhimi i Njësisë,

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Zyra Juridike, të marri të gjitha masat duke ndjekur të gjitha shkallët gjyqësore për arkëtimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore, në vlerën **19,053,367 lekë**.

Brenda muajit Mars 2015

2. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar procedurat tatimore për arkëtimin e detyrimeve të pambledhura në shumën totale **87,783,240 lekë**, nga e cila; taksë nga ndërtesat 5,001,120 lekë, taksë për tokën 9,271,000 lekë, taksë hoteli 8,242,000 lekë, taksë për zënie hapësire publike 65,269,120 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrë masat për zbatimin e procedurave tatimore në arkëtimin e detyrimeve të pambledhura në shumën totale **87,783,240 lekë**, nga e cila; taksë nga ndërtesat 5,001,120 lekë, taksë për tokën 9,271,000 lekë, taksë hoteli 8,242,000 lekë, taksë për zënie hapësire publike 65,269,120 lekë,.

Brenda muajit Mars 2015

3. Gjetje nga auditimi: Në strukturën organizative nuk janë përfshirë në drejtimin institucional specialist të arsimuar si “Inxhinier për Mbarështimin e Pyjeve” në funksionin e menaxherit në DMMT dhe në funksionin e Policit Pyjor në Policinë Bashkiake.

Rekomandimi:

3.1 Bashkia Himarë të paraqesë në Këshillin Bashkiake projekt për të rishikuar strukturën organizative për të përfshirë brenda tyre specialist të arsimuar në drejtimin “Inxhinier për Mbarështimin e Pyjeve”, në funksionin e menaxherit në DMMT dhe në funksionin e Policit Pyjor në Policinë Bashkiake.

Brenda muajit Janar 2015

4. Gjetje nga auditimi: Nuk ndodhen në zyrën e arkivit kontratat e munguara për dhënien me qira të sipërfaqeve kullosore dhe tokë bujqësore (të dhëna në të gjithë periudhën e audituar 2008-2011), dhe nuk është bërë arkivimi i tyre sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe nuk është bërë rivlerësimi faktik i tyre.

4.1. Rekomandimi: Zyra e Kadastrës në bashkëpunim me Zyrën e Arshivës të marrë masa dhe të gjenden kontratat e munguara për dhënien me qira të sipërfaqeve kullosore dhe tokë bujqësore (të dhëna në të gjithë periudhën e audituar 2008-2011), si dhe të bëhet arkivimi i tyre sipas rregullave të përcaktuara në ligjin “Për arkivat”, si dhe të bëhet rivlerësimi faktik i tyre.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nuk janë marrë masa, dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore në të gjithë hapat e trajtimit gjyqësor, për arkëtim e të ardhurave për dhënien me qira të kullotave dhe livadheve, si dhe dhënien me qira të sipërfaqes së tokës për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, si më poshtë:

Për vitin 2008 të ardhurat e paarkëtuara janë 53,250 lekë (sipas Aneksit nr. 1 Pasqyra e llogaritjes së vlerës së kontratave të dhënies me qira për kullotje) dhe 1,149,250 lekë (sipas Aneksit nr. 7 Pasqyra e llogaritjes së vlerës së kontratave të dhënies me qira të sipërfaqes së tokës për ushtrim biznesi).

Për vitin 2009 të ardhurat e paarkëtuara janë 100,750 lekë (sipas Aneksit nr. 2 Pasqyra e llogaritjes së vlerës së kontratave të dhënies me qira për kullotje).

Për vitin 2011 të ardhurat e pa arkëtuara 792,000 lekë (sipas Aneksit nr. 8 Pasqyra e llogaritjes së vlerës së kontratave për dhënien me qira për ushtrimin e biznesit).

-Për arkëtimin e të ardhurave nga shoqëritë “XXX” dhe “XXXX”, për periudhën 2008-2011, si më poshtë:

XXX sh.a 3,000,000 lekë,

XXX sh.a 184,592 lekë, (trajtuar më hollësisht në faqet 27-33, të Raport Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrë masa duke ndjekur procedurat ligjore në të gjitha hapat e trajtimit gjyqësor, për arkëtim e të ardhurave të paarkëtuara në vlerën prej **946,000 lekë**, si pasojë e mos arkëtimin të të ardhurave për dhënien me qira të kullotave dhe livadheve, si dhe dhënien me qira të sipërfaqes së tokës për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, për periudhën 2008-2011, si dhe vlerën prej 3,184,592 lekë, për arkëtimin e të ardhurave me shoqëritë e telefonisë “XXX” sh.a dhe “XXXXX” sh.a.

Brenda muajit Prill 2015

6. Gjetje nga auditimi: Nuk janë inventarizuar dhe nuk janë përfshirë në fletë inventarizimi, si dhe nuk kanë denoncuar e kërkuar në organet e rendit, paraqitjen fizike pranë Bashkisë të automjetit “Makina e transportit të plehrave”, me karakteristikat: Nisan TK 395 viti 2007, shasi nr. VEHNFTKO 64008320, me vlerë 4,809,383 lekë dhe të mjetit tip fugon i policisë Bashkiake VL 0716 C, me vlerë 1,057,305 lekë, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë dhe Drejtoria Ekonomike të inventarizojë, përfshijë në fletë inventarizimi dhe të denoncojë e kërkojë në organet e rendit, paraqitjen fizike pranë Bashkisë të automjetit “Makinën e transportit të plehrave”, me karakteristikat: Nisan TK 395 viti 2007, me vlerë 4,809,383 lekë dhe të mjetit tip fugon në përdorim të policisë bashkiake me targë VL 0716 C, me vlerë 1,057,305 lekë.

Brenda muajit Mars 2015

7. Gjetje nga auditimi: Nuk është kryer arkëtimi për 31 raste debitor në shumën 28,370,399 lekë. Nga këto është nxjerr urdhër njoftimit për shlyerje detyrimi, vetëm për 15 raste në shumën 14,689,882 lekë dhe nuk janë nxjerr urdhër për shlyerje detyrimi në 16 raste në shumën 14,257,212 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e

sistemit buxhetor” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të nxjerr urdhër për shlyerje detyrimi në 16 raste në shumën **14,257,212 lekë**, ndërsa Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike të marri masa duke ndjekur procedurat ligjore dhe të gjitha hapat e trajtimit gjyqësor, për arkëtim e të ardhurave të paarkëtuara, në shumën **28,370,399 lekë**.

Brenda muajit Mars 2015

8. Gjetje nga auditimi: Planifikimi i të ardhurave për taksat e tarifave vendore nuk është në proporcion me mundësitë reale që ka kjo njësi vendore, ku në disa zëra planifikimi është disa herë më i vogël se sa ai duhet të ishte në fakt, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”,

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa për planifikimin real të taksave e tarifave, bazuar në të dhënat që disponon kjo Bashki, si: numrin e subjekteve aktiv dhe sezonal, sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, sipërfaqen e tokës bujqësore të ndarë, numrin e hoteleve dhe dhomave me qira, etj, duke i programuar analitikisht në mënyrë që niveli i planifikimit të tyre të vijë me prognozë rritje.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Sipërfaqja e tokës bujqësore të ndarë sipas dispozitave të ligjit nr. 7501 “Për Tokën”, nuk është e gjitha me bonitet VII-X, pasi toka bujqësore në fshatin Qeparo me sipërfaqe 280 ha është me bonitet V, ku referuar pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, tarifa paraqitet për vlerën 3,000 lekë/ha/vit.

9.1 Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të marrë masat për evidentimin e banorëve të fshatit Qeparo që disponojnë tokë bujqësore me bonitet V, si dhe të llogarisë e arkëtojnë detyrimin e taksës së tokës bujqësore me vlerë **1,008,000 lekë** (mungesë të ardhurash), duke nxjerrjen njoftim e vlerësimit tatimor.

Brenda muajit Prill 2015

10. Gjetje nga auditimi: Mungon bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore (agjent tatimorë), në evidentimin e detyrimeve që ato duhet të arkëtojnë dhe derdhin për llogari të Bashkisë Himarë, veprime në kundërshtim me nenit 7 dhe 61, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore”, UMF nr. 24, datë 02/09/2008 “Për Procedurat Tatimore”, si dhe udhëzimit të përbashkët të MPVD dhe MF nr. 9, datë 04/0/2003 “Për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit”.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore, të marrë masa organizative dhe ligjore për një ndjekje dhe arkëtim të taksave që arkëtohen nga njësitë e tjera publike (D.P.SH.T.Rr Vlorë, ZVRPP Vlorë) etj, duke kërkuar e bërë rakordime periodike si dhe në ushtrimin e të drejtës ligjore për të ndikuar mbi agjentët tatimor, proces i cili duhet të sjellë ndryshime në rritje për treguesit e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrimit “Mbi sipërfaqet e objekteve të ndërtimit”, hartuar nga Drejtoria e Planifikim Kontrolli dhe Zhvillimit të Territorit (ish-Drejtoria e Urbanistikës) rezulton se, taksa e ndërtesës nuk aplikohet për të gjithë abonentët familjarë që janë të regjistruar në këtë njësi vendore, veprime në kundërshtim me nenin 4 dhe 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” dhe nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”,

11.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për njoftimin e 2635 abonentëve familjarë, mbi detyrimet që kanë për taksën e ndërtesës dhe arkëtimin e vlerës prej **4,054,206 lekë** (periudha 3 vjeçare) e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë.

Brenda muajit Mars 2015

12. Gjetje nga auditimi: Nuk është mbajtur dhe plotësuar regjistri themelor i subjekteve me status aktiv, pasiv dhe të mbyllur dhe abonentëve familjarë, si dhe nuk janë ushtruar kontrole në subjekte të ndryshme mbi mbajtjen e dokumentacion ligjorë, veprime që vijnë në kundërshtim me pikën 7 të nenit 3 dhe pikën 4 të nenit 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, pikën 10-kontrolli tatimor, të udhëzimit të përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për përcaktimin e uniformi tetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”*, si dhe nenit 61, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore”*.

12.1 Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, për:

-Hartimin e regjistrat themelor të subjekteve fizik, juridik dhe abonentëve familjarë, për taksën/tarifën e biznesit, tokës bujqësore, ndërtesës, pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit etj.

-Hartimin e planit vjetor dhe mujor për ushtrimin e kontroleve në drejtimet e përcaktuara, në zbatim të pikës 10 *“Kontrolli tatimor”*, të udhëzimit nr. 655/1, datë 06.02.2007.

-Njoftimin e të gjithë subjekteve/abonentëve privat/familjarë, mbi detyrimet që ato kanë për taksat dhe tarifatat vendore që ato duhet të paguar brenda afateve ligjore.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve privat (subjekte fizik/juridik) dhe abonentëve familjarë, si dhe nuk janë aplikuar gjobat për mos likuidim në afat të detyrimeve, për **2390 raste** me vlerë **38,856,969 lekë**, veprime kundërshtim me nenin 5, shkronja “ç” nën-pika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, dhe nenet 88-91 dhe 114, të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore”*,

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Ekonomike, të kërkojë në rrugë administrative e ligjore arkëtimin e detyrimeve të debitorëve për **2390 raste** me vlerë prej **38,856,969 lekë**, sipas listave të vetëdisponuara, nga e cila 140 subjekte private (fizik/juridik) në vlerën 26,332,040 lekë dhe 2250 abonent familjarë në shumën 12,524,929 lekë.

Brenda muajit Prill 2015

13.2 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të aplikojë vendosjen e gjobave në masën 5-25% të detyrimit të palikujduar në afatin e caktuar, si dhe të bëhet kontabilizimi i tyre në financë, për **76 subjekte me vlerë 3,438,840 lekë**.

Brenda muajit Prill 2015

14. Gjetje nga auditimi: Llogaritja për taksën e ndërtesës ndaj subjekteve private dhe abonentëve familjarë nuk është bërë në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, pasi në asnjë dosje nuk disponohej dokumentacion ligjor për llogaritjen e tij, si: të dhënat e marra mbi sipërfaqet nga ZVRPP Vlorë, genplanet e objekteve të paraqitura nga vetë subjektet, të dhënat mbi lejet e ndërtimit/përdorimit të lëshuara nga Drejtoria e Urbanistikës ose ngritja e grupeve të punës për evidentimin e sipërfaqeve të objekteve të ndërtimit.

14.1 Rekomandimi: Drejtorin e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Kontrolli dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësitë që kanë dosjet, kryesisht për aktet e pronësisë të subjekteve, të ngrihet komisioni i përbashkët për verifikimin e sipërfaqes së pronësisë të çdo subjekti dhe abonentit familjarë, mbi bazën e të cilave të përlllogariten detyrimet për taksën e ndërtesës.

Brenda muajit Prill 2015

15. Gjetje nga auditimi: Nuk është kryer inventarizimi i pronave që administron bashkia, sipas listës paraprake të pronave të miratuara me VKM nr. 362, datë 05.06.2003, si dhe evidentimin e tyre në terren mbi gjendjen faktike në të cilën ato ndodhen, duke hartuar listën përfundimtare të pronave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 *“Për pronat e paluajtshme të shtetit”* dhe pikat 9,10 e 13, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”*.

15.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë me qëllim kalimin në pronësi e përdorim të pronave të ngrejë grup pune dhe të procedojë menjëherë për saktësimin e inventarit të pasurive të paluajtshme, kryerjen e inventarizimit të aseteve mbi numrin dhe sipërfaqen e tyre, si dhe gjendjen fizike (për objektet), duke paraqitur në Këshillin Bashkiak listën e inventarit të azhurnuar të të gjitha pasurive të paluajtshme në administrim të njësisë vendore të cilat duhet të marrin miratimin e Ministrisë së linjës e më tej të Këshillit të Ministrave.

Brenda muajit Prill 2015

16. Gjetje nga auditimi: Nuk ka informacion mbi sasinë e tokës së ndarë në zbatim të VKM nr. 531, datë 21.8.1998 *“Për tokat bujqësore të pandara”*, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 *“Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”*, pasi sipas të dhënave të evidentuara nga auditimi, rezulton se për 38 ha tokë bujqësore nuk ka asnjë të dhënë.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit dhe e Mbrojtjes së Tokës të hartojë dhe mbajë në format elektronik bilancin e fondit të tokës për sipërfaqen në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore (ku evidentohen 2207 ha), fondin e tokës zënë me pyje, fondin e tokës zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës-truall, si dhe të pasqyrohen ndryshimet sipas kategorive të resurseve.

Brenda muajit Prill 2015

17. Gjetje nga auditimi: Nuk është bërë evidentimi në regjistër i kontratave të lidhura për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore për kullotë dhe bimë medicinale, si dhe shpallja e listave për kullotat e gatshme dhe kositje brenda muajit shkurt të çdo viti, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 *“Për fondin kullor”*, VKM nr. 162, datë 07.07.2007, ndryshuar me VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 dhe nr. 529, datë 8.6.2011 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, si dhe pikën 3 dhe 4, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 *“Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”*.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, të marrë masa dhe të bëjë listimin dhe azhurnimin e të gjitha sipërfaqeve të dhëna me qira, duke hartuar regjistrin përkatës dhe ndjekur në mënyrë periodike detyrimet kontraktuale (Në regjistër të vendosen të gjithë treguesit e nevojshëm për vlerësimin e kontratës), shpallja e listave me kullotat e gatshme brenda muajit shkurt të çdo viti, plotësimi i tyre me dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor të secilës praktike të dhënies me qira, si dhe për çdo rast të bëhet miratimi apo pëlqimi i dhënies me qira nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë dhe vazhdimisht

18. Gjetje nga auditimi: Nuk është bërë evidentimi i objekteve ndihmëse që i shërbejnë kontratave të kullotjes si; stane, kasolle për bagëti etj, kjo pasi nuk janë ushtruar kontrole për verifikimin në vend të tyre, veprime në kundërshtim me shkronja c, pika 5, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008.

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, të ushtrojë kontrole në të gjitha kontratat e lidhura për kullotë, duke evidentuar lloj e objektit ndihmës për llogaritjen e detyrimeve që rrjedhin nga ndërtimi i tyre për vlerën e munguar **prej 371,000 lekë**.

Brenda muajit Prill 2015

19. Gjetje nga auditimi: Janë lëshuar Akte të Marrjes së Tokës në Përdorim, jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 253 datë 06.03.2013 *“Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativës bujqësore”*, pasi:

-Personat e pajisur me AMTP , nuk janë subjekt i ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 *“Për Tokën”*, ligjit nr. 58/2012, datë 17.05.2012 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”* dhe VKM nr. 253, datë 06.03.2013.

-Për mjaft raste sipërfaqja e miratuar me AMTP është më e madhe se të dhënat e paraqitura nga Kryesia e Pleqve dhe konkretisht fshati Gjilekë, veprime në kundërshtim me pikën 8, të VKM nr. 253, datë 06.03.2013.

-Në 14 raste sipërfaqja e miratuar me AMTP është më e madhe se sipërfaqja që Këshilli Bashkiak ka miratuar për këta persona me VKB nr. 158, datë 05.12.2013.

-Në 10 raste personat e pajisur me AMTP nuk rezultojnë banorë të fshatrave respektiv sipas gjendjes civile datë 01.08.1991, duke mos plotësuar kushtin e shkronjës “a” të pikës 4, të VKM nr. 253, datë 06.03.2013.

-Në një rast personi është pajisur me AMTP të re, ndërkohë që ka qenë më parë i pajisur me AMTP, veprime në kundërshtim me shkronjën “a” të pikës 4, të VKM nr. 253, datë 06.03.2013.

Në dy raste AMTP janë dhënë në kundërshtim me nenin 14 dhe 18, të ligjit nr. 58/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 të ndryshuar, dhe pikës 13, të VKM nr. 253, datë 06.03.2013.

19.1. Rekomandimi:

a. Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të marrë masat në referim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proedurës Administrative”, t’i kërkojë Këshillit Bashkiak rishikimin e Vendimit nr. 158, datë 05.12.2013 të KB “Për miratimin e listës së përdoruesve faktik të tokës bujqësore, si dhe emrat e subjekteve përfitues në Bashkinë Himarë”. Ndërsa për personat e pajisur me AMTP, t’i kërkohej Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë shfuqizimin e tyre, si dhe njoftimin e ZVRPP Vlorë.

b. Bashkia Himarë të marrë masa dhe në zbatim të rekomandimit të dhënë nga ana e KLSH, ti dërgojë shkresë ZVRPP Vlorë dhe ZQRPP për kufizimin e këtyre pronave, deri në plotësimin me dokumentacion ligjor dhe konfirmimin e ligjshmërisë ose paligjshmërinë nga Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, duke njoftuar njëkohësisht dhe KLSH.

Menjëherë

19.2 Drejtoria e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për çdo rast të konfirmimit të AMTP dhe dërgimit për regjistrim në ZVRPP, më parë të rakordojë dhe të marrë konfirmim shkresor nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, lidhur me detyrimet e përfaqësuesit të familjes bujqësore mbi pagesën e taksës për tokën.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e preventivit për objektin “*Varrezat e Himarës, faza e III*”, nuk janë marrë parasysh dispozitat e VKM nr. 708, datë 12.10.2011 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*” dhe pikat 2, 3 dhe 9, të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*”, pasi preventivi i hartuar është më i lartë se preventivi sipas çmimeve të manualit të Vendimit nr. 30, datë 20.01.2010, duke preventivuar më tepër dhe rritur fondin limit në vlerën 1,932,872 lekë pa tvsh.

20.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për gritjen e grupit të punës për azhurnimin e të gjitha projekteve të hartuar, duke i hartuar në përputhje me kushtet e reja të terrenit (nëse janë konstatuar ndryshime), si dhe të kryhet azhurnimi i tyre në përputhje me manualet teknikë të çmimeve.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Struktura e Inspektoratit Ndërtimore Urbanistik Vendor (INUV), nuk është në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 11, të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, pasi punonjësit e emëruar janë pa arsimin përkatës.

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Personelit në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrë masa për plotësimin e strukturës të INUV, me specialistë që plotësojnë kriteret arsimore e profesionale.

Brenda muajit Prill 2015

22. Gjetje nga auditimi: Janë aplikuar 276 gjoba me vlerë 34,090,000 lekë për ndërtime të paligjshme, por nuk janë kontabilizuar ato dhe as nuk është ndjekur procedurë ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me nenin 22, 30 e 44, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*", ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*" dhe Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

22.1 Rekomandimi: Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, Zyrën Juridike dhe Policinë Bashkiake, të marrë masat për kontabilizimin e gjobave të aplikuara për ndërtimet e paligjshme, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e **276 gjobave me vlerë 34,090,000 lekë**, si dhe të ndjekë procedurat përkatëse penalizuese.

Brenda muajit Prill 2015

23. Gjetje nga auditimi: Nuk është kryer regjistrimi në kontabilitet dhe nuk janë arkëtuar 65 gjoba me vlerë 5,358,500 lekë, të aplikuara nga policia bashkiake për shkelje të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje, hedhjen e mbeturinave inerte, bllokimin e trotuareve, transportin e mjeteve etj, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për Procedurat Tatimore*", ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*" dhe Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

23.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masat për kontabilizimin e 65 gjobave të aplikuara, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e vlerës 5,358,500 lekë, mungesë të ardhurash.

Brenda muajit Prill 2015

24. Gjetje nga auditimi: Nuk është arkëtuar nga subjekti "Th.R" vlera e plotë e detyrimit prej 1,230,520 lekë, pasi edhe pse është kërkuar bllokim i llogarive bankare me qëllim shlyerjen e tij, subjekti ende mbetet debitor për vlerën prej 662,580 lekë. Për detyrimin, pavarësisht se subjekti e ka paguar pjesërisht atë nuk është proceduar me kontabilizimin e vlerës dhe regjistrimin e subjektit si debitor, veprime në kundërshtim me nenin 89-90 të ligjit nr. 9920, datë 28.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*".

24.1 Rekomandimi. Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Policinë Bashkiake, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e diferencës së detyrimit nga subjekti "Th.R" prej 662,580 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit (mungesë të ardhurash).

Brenda muajit Prill 2015

25. Gjetje nga auditimi: Njësia e Qeverisjes Vendore Bashkia Himarë, gjatë periudhës 24 mujore nga miratimi i Planit të Përgjithshëm Vendor, deri në 01.06.2014, ka miratuar vetëm një Plan të Detajuar Vendor, duke mos përmbushur kështu detyrimin ligjor të pajisjes të gjithë territorin në juridiksion të saj me instrumente të detajuara vendore, konform nenit 45/1, pika 2 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "*Për Planifikimin e Territorit*".

25.1 Rekomandim: Të hartohen dhe miratohen dokumentet vendore të planifikimit, Plane e Detajuara Vendore, sipas afatit të përcaktuar jo më vonë se 2 vjet nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*".

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Në mbledhjen nr. 1 datë 06.08.2013 të Këshillit Teknik të Bashkisë Himarë, në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor, janë trajtuar dhe miratuar "*Resort me Vila*" dhe tre "*Masterplane*", ndërkohë kur termat "*Resort me vila*" dhe "*Masterplan*" nuk ekzistojnë në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "*Për Planifikimin e Territorit*" dhe sipas nenit 27 të këtij ligji i vetmi akt administrativ që hartohet në zbatim dhe detajim të instrumentit të

përgjithshëm vendor është Plani i Detajuar Vendor, duke bërë që Instrumentet e trajtuara gjatë kësaj mbledhje të jenë të pa mbështetura në dispozitat ligjore aktuale.

26.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të hartohen dhe miratohen dokumentet vendore të planifikimit, Plane të Detajuara Vendore, për njësitë strukturore I.5 Plazhi i Drimadhes, nënjesia strukturore T2.3 nënjesia strukturore T1 në zonën Qeparo i Ri dhe njësia I.5 Plazhi i Drimadhes, nënjesia strukturore T2, në përputhje me nenin 22 të ligji nr. 107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*.

Brenda Qershor 2015

27. Gjetje nga auditimi: Në mbledhjen nr. 1 datë 06.08.2013 të Këshillit Teknik, është propozuar e miratuar me vendim nr. 26, datë 14.10.2013, me nr. 1561 prot. Plani i Detajuar Vendor Jalë (Njësia strukturore II.3.a, Zonat T.1.1, T.1.2 dhe S2). Plani i Detajuar Vendor Jalë ka parashikuar zonë ndërtimi me funksion “Bungalo” dhe sipërfaqe 3933 m², në zonën S2 ku Plani i Përgjithshëm Vendor në fuqi nuk përcakton ndërtime, veprim në kundërshtim me VKM nr. 481, datë 22.6.2011, neni 21/1, pika 1 dhe 2.

Plani i detajuar vendor (PDV) është instrumenti i detajuar vendor, që hartohet si detajim i PPV-së, mbi bazën dhe sipas përcaktimeve të tij. Ky akt është në kundërshtim me referencat ligjore dhe është bërë me synimin për ti dhënë mundësinë e legalizimit ndërtimeve ekzistuese, pa leje, në zonën S2 të konstatuara nga grupi i auditimit gjatë evidentimit në terren të datës 09.10.2014.

27.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të rishikohet Plani i Detajuar Vendor Jalë, në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë dhe nenit 22 të ligjit nr. 107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*.

Brenda Qershor 2015

28. Gjetje nga auditimi: Bashkia Himarë gjatë vitit 2013 ka miratuar dhe zbardhur 3 leje zhvillimi, 2 prej të cilave kanë rezultuar me shkelje e mangësi ligjore si më poshtë:

- Objekt banimi 3, 4 dhe 5 kate dhe 1 kat nëntokë, Spile Himarë, kompania e ndërtimit “A...” sh.p.k., në pronë të V.Z e Dh.Z. Dhënë Leje Zhvillimi nga Bashkia Himarë nr. prot. 1, datë 14.05.2013, data e miratimit të lejes 06.05.2013.

- Objekt lokal shërbimi për zhvillimin e turizmit 1 kat, Spile Himarë, kompania e ndërtimit “ARL Konstruksion” sh.p.k., në pronë të M.K. Dhënë Leje Zhvillimi nga Bashkia Himarë nr. 1663 prot., datë 31.10.2013, data e miratimit të lejes 31.10.2013.

Këto leje janë dhënë pa u shqyrtuar më parë në Këshillin Teknik, leja e dytë është dhënë në mungesë të certifikatës së pronësisë apo vërtetimit nga dokument hipotekor, lejet nuk janë dhënë sipas Formularit TIP 2, duke mos përmbushur detyrimin e përcaktimit të të dhënave të përgjithshme dhe kondicioneve teknike në leje, paqartësi dhe mospërputhje në llogaritjen e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit dhe nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për dokumentacionin që përmban një leje zhvillimi konform Shtojcës 2, Formulari Tip. 1, Seksioni 8, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011, të ndryshuar.

28.1 Rekomandim: Përpara miratimit të Certifikatës së Përdorimit ti kërkohet subjekteve zhvilluese të plotësojnë mangësitë në dokumentacionin e lejeve të zhvillimit për objektet:

- Objekt banimi 3, 4 dhe 5 kate dhe 1 kat nëntokë, Spile Himarë, kompania e ndërtimit “ANDI” sh.p.k., në pronë të V.Z e Dh.Z. Dhënë Leje Zhvillimi nga Bashkia Himarë nr. prot. 1, datë 14.05.2013, data e miratimit të lejes 06.05.2013.

- Objekt lokal shërbimi për zhvillimin e turizmit 1 kat, Spile Himarë, kompania e ndërtimit “A.....Konstruksion” sh.p.k., në pronë të M.K. Dhënë Leje Zhvillimi nga Bashkia Himarë nr. 1663 prot., datë 31.10.2013, data e miratimit të lejes 31.10.2013.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT) Bashkia Himarë, për 3 prej 48 objekteve të evidentuara në terren nga grupi i audituesve të KLSH, më datë 09.10.2014, të cilat janë të ndërtuar apo janë në fazën e ndërtimit, shprehet se nuk ka informacion,

duke konfirmuar kështu se nuk ka kryer detyrën për evidentimin dhe marrjen e informacionit për zhvillimet në territorin që ka nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, në kundërshtim me ligjin nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, Seksioni VII “Vëzhgimi, Inspektimi”, “Kundravajtjet e Dënimit”, neni 80 “Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren”, pika 1 dhe 2.

29.1 Rekomandim: Nga ana e DPZHT dhe INUV Bashkia Himarë të kryhen vëzhgime të vazhdueshme për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit, si edhe të merren masa për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me autoritetet vendore e kombëtare të planifikimit për vendimmarrjet e kryera nga autoritete të tjera për territorin e Bashkisë Himarë.

Në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Bashkia Himarë bazuar në Aktin Normativ të KM nr. 1, datë 6.2.2013 “Për pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, (Miratuar me ligjin nr.96/2013, datë 04.03.2013) ka miratuar dhe zbardhur 7 leje zhvillimore, nga të cilat u audituan 4 praktika, si më poshtë:

1. Leje zhvillimi me dokument nr. 1132 prot. datë 05.08.2013, për objekt banimi 4 dhe 5 kate, Spile Himarë, për subjektin A...ST.....shpk.
2. Leje zhvillimi me dokument nr. 1487 prot. datë 04.10.2013, për objekt banimi 4 kate, Potam Himarë, për subjektin “R... ”.
3. Leje zhvillimi me dokument nr. 2 prot. datë 11.07.2013, për objekt hotel 3 kate me dy kate podrum në Dhërm, për subjektin “P.....” shpk.
4. Leja e zhvillimit me dokument nr. 1120 prot. datë 01.08.2013, për zhvilluesin “S.....D” shpk në pronën e A. M, për 2 godina banimi 4 kate dhe një kat podrum në Potam.

Lejet e ndërtimit të cituara më sipër janë dhënë në mungesë të dokumentit të certifikatës së pronësisë apo vërtetimit të pronësisë nga ZVRPP Vlorë, por janë bazuar vetëm në akte të marrjes së tokës në pronësi.

Nga DPZHT e Bashkisë Himarë është përlogaritur gabim taksa 4% e lejeve të ndërtimit, e lejeve të zhvillimit për shtesat pa leje në objekte me leje si edhe është shqyrtuar e miratuar kërkesa për këto të fundit pa dokumentin që vërteton pagesën e gjobës konform nenit 82 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009, duke i shkaktuar buxhetit të njësisë vendore një dëm ekonomik në vlerën 10,379,302 lekë.

30.1 Rekomandim: Nga Bashkia Himarë, DPZHT, Certifikata e Përdorimit për objektet e sipërcituara të miratohet vetëm pas arkëtimit të gjobave dhe vlerës së papaguar të taksave të lejeve të ndërtimit e zhvillimit, si dhe paraqitjes së dokumentit të pronësisë (Certifikatë apo vërtetim pronësie) të lëshuar nga ZVRPP Vlorë.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga evidentimi në terren i kryer nga grupi i auditimit të KLSH më datë 09.10.2014 për objektet e ndërtuara apo në proces ndërtimi në hapësirën bregdetare Qeparo-Drimadhë, u identifikuan 48 objekte apo komplekse ndërtimi, nga ku rezultoi se:

Për 14 (katërbëdhjetë) objekte pa leje Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) Bashkia Himarë, nuk ka ndërmarrë asnjë masë duke mos kryer detyrën, kjo në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, të ndryshuar, neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, si dhe në kundërshtim të plotë me nenin 5 të këtij ligji “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”.

31.1 Rekomandim: Nga Bashkia Himarë, në përputhje e zbatim të referencave ligjore që rregullojnë fushën e ndërtimit dhe inspektimit të ndërtimit, që për objektet e kundërligjshëm të shprehet me vendimmarrje për Prishjen e Ndërtimeve, Informimin e Inspektoratit Ndërtimor

Urbanistik Kombëtar për të gjitha ndërtimet, dhe përgatitjen e Kallëzimeve Penale për 14 kundërvajtësit, si më poshtë:

1. Objekt pa leje Qeparo, pronari Th.L;
2. Objekt pa leje Qeparo, pronari L. K;
3. Objekt pa leje Porto Palermo, pronari M.K;
4. Objekt pa leje Potam, pronari F.G;
5. Objekt pa leje Potam, pronari Th. K;
6. Objekt pa leje Livadhë, pronari J. K;
7. Objekt pa leje Livadhë, pronari K.J;
8. Objekt pa leje Livadhë, pronari P.J;
9. Objekt pa leje në Livadhë, pronari i paidentifikuar;
10. Objekt pa leje në Livadhë, pronari K.B;
11. Objekt pa leje në Livadhë, pronari K;
12. Objekt pa leje në Livadhë, pronari K;
13. Objekt pa leje në Dhërmi, pronari Hotel G;
14. Objekt pa leje në Dhërmi, pronari i paidentifikuar;

Menjëherë

32. Gjetje nga auditimi: Nga INUV Bashkia Himarë në 6 raste për objektet pa leje, si më poshtë: objekt në Potam, në pronësi të Pano Bilushi, objekt në Drimadhë, në pronësi të Spiro Kocanit dhe 4 objekte në Jalë, në pronësi të “F.....M....”, procedurat e kryera konsistojnë vetëm në mbajtje Proces-Verbalesh, Vendime për Dënim me Gjobë dhe Vendime për Pezullimin e Punimeve në Ndërtim dhe në asnjë rast nuk janë shoqëruar me masat e tjera të parashikuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, të ndryshuar, neni 5 “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës” si dhe VKM nr. 862, datë 5.12.2007, pika 8,

32.1 Rekomandim: Nga Bashkia Himarë të merret vendimi konform ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 dhe të bëhet Informimi i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, të përgatitet dhe dorëzohet në Prokurori Kallëzim Penal për kundërvajtësit, paraqitjen pranë organeve përkatëse të kërkesës për heqje të licencës profesionale ose të shoqërisë, për objektin në Potam, në pronësi të P.B, objektin në Drimadhë, në pronësi të S.K dhe 4 objekte në Jalë, në pronësi të “F... M...”.

Menjëherë

33.Gjetje nga auditimi: Për 3 objekte, kompleks 3 kate në ndërtim plazh Qeparo, objekt 4 kate i ndërtuar në Potam-Himarë dhe objekt 4 kate në ndërtim Livadhë me pronarë të paidentifikuar, për të cilat nga informacioni paraprak i dhënë nga Bashkia Himarë, si dhe nga informacioni pjesor i fituar nga auditimi tematik “Për verifikimin e dokumentacionit për vendimmarrjet e lejeve të ndërtimit dhe planeve urbanistike për periudhën 01.01.1998 – 31.12.2005”, të miratuara nga Këshilli i Qarkut Vlorë për territorin e Bashkisë Himarë, rezulton se objektet janë me mungesë apo dokumentacion të pa mirë administruar. Për më tepër nga analizimi i përputhshmërisë me studimet urbane në fuqi rezulton se objektet nuk mund të referohen në VKM nr. 438, datë 28.06.2006, të ndryshuar, neni 2, pika c/1) pasi nuk janë sipas studimeve urbane dhe instrumentet e planifikimit të territorit në fuqi dhe nuk respektojnë distancat e përcaktuara nga këto të fundit, në lidhje me fashën bregdetare ku ndalohet ndërtimi.

Për objektet, INUV nuk ka ndërmarrë asnjë masë duke mos kryer detyrën, kjo në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, si dhe në kundërshtim të plotë me nenin 5 të këtij ligji “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”,

33.1 Rekomandim: Nga Bashkia Himarë, DPZHT dhe INUV të marrë masa në lidhje me ndërtimet pa dokumentacion ose pa leje (emërtimet e secilit), për të paraqitur në KLSH dokumentacionin përkatës për secilin objekt, nëse disponohet, duke na paraqitur njëkohësisht mendimin tuaj zyrtar mbi ligjshmërinë apo paligjshmërinë e tyre. Dokumentacion që do të

paraqisni të jetë i njehsuar me origjinalin, me vulë të njomë të Bashkisë Himarë si dhe me fletë inventarizimi ku të shkruhet forma që disponohet (originale, kopje e njësuar apo fotokopje) si dhe numri i fletëve.

Brenda muajit Prill 2015

34. Gjetje nga auditimi: Mbi verifikimin e praktikës ankimore nr. 753, datë 27.11.2014, sipas autorizimit nr. 753/2, datë 05.12.2014 të Kryetarit të KLSH *“Mbi auditimin e lejeve ndërtimore të ish-KRRT Bashkia Himarë nr. 4, datë 14.02.2008 në emër të V...R dhe lejes ndërtimore të ish-KRRT Bashkia Himarë nr. 36, datë 16.12.2010 në emër të Pavllo Zoto”* nga ku rezultoi:

Leja ndërtimore nr. 4, datë 14.02.2008 në emër të V.R dhënë për 4 objekte 2 katëshe, në zonën kadastrale nr. 1952, Himarë, për investitorin V.R, dhe leja ndërtimore nr. 36, datë 16.12.2010, në emër të P.Z si dhe studimi ka si objekt *“Kompleks Vilash”* 9 objekte, në vendin e quajtur *“Lera”*, Zona Kadastrale nr. 1952, për pasuritë nr. 564/1, 564/2, 564/3, janë miratuar:

Pa u disponuar një dokument i ligjshëm mbi pronësinë e tokës bujqësore të llojit *“Ullishte”* të lëshuar nga ZVRPP Vlorë; vendndodhja e parcelës ku rezulton të jenë miratuar dy lejet ndërtimore, është e ndryshme nga ajo sipas AMTP, pasi akti është lëshuar për një sipërfaqe prej 3000 m² në vendin e quajtur *“Lera”* ndërsa objektet janë ndërtuar në vendin e quajtur *“Xhami”*, por me vend të ndryshuar.

Leja e sheshit dhe e ndërtimit është dhënë sipas një studimi i cili nuk bazohet në një Plan Rregullues të Përgjithshëm dhe nuk plotëson kërkesat e ligjit për të qenë një Studim Urbanistik Pjesor;

Kondicionet urbane të planimetrisë së sheshit të ndërtimit të miratuar nuk përputhen me ato të lejes sipas Formularit nr. 2;

E gjithë praktika e 2 lejeve të mësipërme ka mangësi të theksuara në dokumentacionin e detyrueshëm për pajisjen me Leje Ndërtimi.

Dhënia e 2 lejeve të mësipërme është në tejkalim të kompetencave të dhëna sipas ligjit të kohës nr. 8405, datë 17.09.1998 *“Për Urbanistikën”*, si dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 *“Për Miratimin e Rregullores së Urbanistikës”*.

34.1 Rekomandim: Bashkia Himarë, DPZHT dhe INUV bazuar në konstatimet e mësipërme të merren të gjitha masat për pezullimin e punimeve të ndërtimit për lejet e sipërcituara, deri në saktësimin dhe paraqitjen e dokumenteve si më poshtë:

- Shprehjen mbi ligjshmërinë e AMTP dhënë në favor të V.R, nga Prefektit i Qarkut Vlorë, Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, referuar ligjit nr. 9948 datë 07.7.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”*;

- Dokumentit të pronësisë (Certifikatë apo vërtetim pronësie) të lëshuar nga ZVRPP Vlorë;

- Aktmarrëveshje midis pronarëve të trullit sipas dokumentit të pronësisë të lëshuar nga ZVRPP Vlorë dhe sipërmarrësit/investitorit;

- Pozicionimit ligjor të parcelës ndërtimore ku rezulton të jenë miratuar dy lejet ndërtimore, në vendin e quajtur *“Lera”* apo në vendin e quajtur *“Xhami”*.

34.2 Nisur nga konstatimi se dosjet janë objekt hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, trajtimi i bërë nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ti dërgohen këtij organi për hetim e vlerësim të mëtejshëm të paligjshmërisë të veprimeve të kryera nga ish-punonjësit e bashkisë.

Brenda muajit Prill 2015

35. Rekomandim: Nga Bashkia Himarë, për subjektet debitore ndaj njësisë vendore, të cilat kanë krijuar dëm ekonomik apo të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit dhe refuzojnë të përmbushin detyrimin, të veprohet si më poshtë:

a-Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore”*.

b-Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e bares siguruese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c-Në rast se subjektet edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Banke dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, pasi tu vendosen masa administrative (*gjobë në masën 25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008*), të kërkohej kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, pikat 130-132 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, i ndryshuar dhe Kodit Penal, neni 181, “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*”.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 08.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pjesa e VI, Kreu i Parë, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **86,539,618 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Pastrimi i Bashkisë Himarë dhe mirëmbajtje varrezave*”, u konstatuan shkelje në drejtim të përcaktimit të saktë të fondit limit, gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, gjatë hapjes dhe vlerësimit të ofertave, si dhe gjatë lidhjes së kontratave, shkelje këto të shoqëruara me efekte financiare në vlerën prej **314,507 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit Publik*”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 80-90, të Raport Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **314,507 lekë** (dëm ekonomik), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, në ngarkim të 4 personave, dhe konkretisht: J.G për vlerën 62,901.4 lekë, A.P për vlerën 62,901.4 lekë, V.L për vlerën 62,901.4 lekë dhe P.Z për vlerën 62,901.4 lekë

Brenda muajit Mars 2015

2. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e preventivit faktik të fondi limit të tenderit me objekt “*Pastrimi i Bashkisë Himarë dhe mirëmbajtje varrezave*”, viti 2013, këtij shërbimi i është vendosur dhe zëri “*Shërbime transport mbeturinash voluminoze, inerte dhe ndërtimore (selektive)*”, zë ky i shoqëruar me analizë kosto si; nga AK ashtu edhe nga OE fitues, veprim në kundërshtim me kreun II-të, neni 5-mbeturinat, neni 6-përrjashtimet, të ligjit nr. 8094, datë 29.03.1996 “*Për largimin publik të mbeturinave*”.

Në preventivin e tenderit të këtij shërbimi është vendosur edhe zëri “*larje speciale*”, i shoqëruar me analizë kostoje nga AK dhe OE fitues, në kërkesat e veçanta të kualifikimit.

Për kapacitetin teknik dhe profesional të DST të miratuara nga Nj.P, nuk është vendosur **makineria teknologjike** për kryerjen e këtij zëri shpenzimi. Veprime në kundërshtim me pikën “ii”-kapacitetet teknike profesionale, paragrafi katër “*dëshmi për mjete e pajisje teknike që janë në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion OE për të përmbushur kontratën*”, kërkesa këto të germës “c”-kontrata shërbimi, pika 3-informacione të veçanta, kreu III-dokumentet e tenderit, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Si rezultat i këtij veprimi, është shkaktuar **një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit me vlerë prej 1,784,274 lekë**, për vitin 2013.

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,784,274 lekë** (dëm ekonomik), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, në ngarkim të 4 personave, konkretisht: J.G për vlerën 446,068 lekë, A.P për vlerën 446,068 lekë, Dh.P për vlerën 446,068 lekë dhe K.K për vlerën 446,068 lekë.

Brenda muajit Mars 2015

3. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e preventivit faktik të fondi limit të tenderit me objekt *“Pastrimi i Bashkisë Himarë dhe mirëmbajtje varrezave”*, viti 2014, këtij shërbimi i është vendosur dhe zëri *“shërbime transport mbeturinash voluminoze, inerte dhe ndërtimore (selektive)”*, zë ky i shoqëruar me analizë kosto si, nga AK ashtu edhe nga OE fitues, veprim në kundërshtim me kreun II-të, neni 5-mbeturinat, neni 6-përfjashtimet, të ligjit nr. 8094, datë 29.03.1996 *“Për largimin publik të mbeturinave”*.

Në preventivin e tenderit të këtij shërbimi është vendosur edhe zëri *“larje speciale e rrugëve”*, i shoqëruar me analizë kostoje nga AK dhe OE fitues.

Në kërkesat e veçanta të kualifikimit *“Për kapacitetin teknik dhe profesional të DST të miratuara nga Nj.P, nuk është kërkuar “makineria teknologjike” për kryerjen e këtij zëri shpenzimi, veprime në kundërshtim me shkronjën “c” të pikës “ii” dhe pikës 3, të kreut III, të VKM nr. 1, datë 10.01.207 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Si rezultat i këtij veprimi të kundërligjshëm (cituar si mësipërm), është shkaktuar **një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit me vlerë prej 2,146,773 lekë** për vitin 2014.

3.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,146,773 lekë** (dëm ekonomik), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, në ngarkim të 6 personave, konkretisht:

-J.G për vlerën 357,795.5 lekë, A.P për vlerën 357,795.5 lekë, E.R për vlerën 357,795.5 lekë, M..L për vlerën 357,795.5 lekë, F.M për vlerën 357,795.5 lekë dhe E.R për vlerën 357,795.5 lekë.

Brenda muajit Mars 2015

4. Gjetje nga auditimi: Për tenderin me objekt *“Studim dhe projektim i zonës së Himarë me përparësi zhvillimin e Turizmit”*, viti 2012, si pasojë e moskryerjes se procedura sipas LPP dhe nga mos argumentimi i kërkesës për shtesë kontrate është shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerë prej 5,579,800 lekë pa TVSH dhe për rrjedhojë edhe përfitim të padrejtë në po këtë vlerë nga Operatori Ekonomik *“Th.... P..... & A.... Inc”*.

4.1. Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **5,579,800 lekë pa tvsh**, nga subjektit përfitues *“Th....P..... & A....Inc”*, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Brenda muajit Mars 2015

5. Gjetje nga auditimi: Për tenderin me objekt *“Trajnimi i administratës”* është paguar subjekti *“Qendra për dialog biznes, parlament”* e përfaqësuar nga E.Gj...., kur subjekti nuk i nënshtrohet TVSH si dhe nuk figuron i regjistruar në QKR, duke u krijuar një dëm ekonomik buxhetit të shtetit në TVSH **për vlerën 333,000 lekë**.

5.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **333,000 lekë**, nga subjekti përfitues *“Qendra për dialog biznes, parlament” e përfaqësuar nga E.Gj*, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Brenda muajit Mars 2015

6.1 Gjetje nga auditimi: Në muajin Prill 2013, operatori ekonomik *“A. Co”* shpk, fitues i shërbimit të pastrimit për vitin 2013, ka paraqitur për likuidim faturën nr. 89, datë 11.04.2013, me vlerë 4,859,274 lekë me TVSH, si dhe situacionin nr. 1, datë 10.04.2014 që i përgjigjet po kësaj fature, situacion ky që bën fjalë për punimet e kryera nga ky operator, për të gjithë zërat e prokuruar për muajt Janar, Shkurt, Mars 2013, në një kohë që ky operator ekonomik është **shpallur fitues me datën 02.04.2014**, me të cilën është lidhur kontrata nr. 24, datë 02.04.2014.

Sa më sipërm, **vlera prej 4,049,695 lekë** e paraqitur për likuidim nga operatori ekonomik *“A. Co”* shpk, për shërbimin e *“Pastrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave”* për muajt Janar-Mars 2013

dhe e likuiduar nga Autoriteti Kontraktor është i paargumentuar dhe përbën shkelje të disiplinës me dëm ekonomik. në kundërshtim me shkronjën “dh” dhe “ë” të nenit 12, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” si dhe të nenit 35, shkronja “a”, “b”, “c”, neni 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve*”.

6.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **4,049,695 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, në ngarkim të Operatorit Ekonomik “A... co” sh.p.k.

Brenda muajit Mars 2015

7. Gjetje nga auditimi: Në preventivin përmbledhës, “*Shërbimi i pastrimit*” i operatorit ekonomik “A..co”, preventiv ky për shërbimin e pastrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave, për muajt Tetor-Dhjetor 2012, janë përfshirë edhe 2 zëra pune: “*Pastrim dhe mirëmbajtje plazhi*” me vlerë 675,000 lekë pa tvsh; “*Larje shëtitore*” me vlerë 225,000 lekë pa tvsh. Këto 2 zëra me vlerë 900,000 lekë pa tvsh dhe 1,080,000 lekë me tvsh si dhe likuidimi i tyre së bashku me shërbimet e tjera nga Autoriteti Kontraktor me urdhër-shpenzimet nr. 235, datë 23.11.2012, nr. 12, datë 06.02.2013 dhe urdhër-shpenzimi nr. 13, datë 06.02.2013, gjithsej vlera 3,237,256 lekë, nga e cila vlera prej 1,080,000 lekë përfaqësojnë zërat e punës të paargumentuar, përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me shkronjën “dh” dhe “ë” të nenit 12, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” si dhe të nenit 35, shkronja “a”, “b”, “c”, neni 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve*”.

7.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,080,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, në ngarkim të 5 punonjësve, konkretisht: A.P për vlerën 270,000 lekë, G.S për vlerën 270,000 lekë, E.V për vlerën 270,000 lekë dhe K.K për vlerën 270,000 lekë.

Brenda muajit Mars 2015

8.1 Gjetje nga auditimi: Në realizimin e investimit publik “Rikonstruksion rrugë të brendshme, Ujësjiellës, KUZ, KUB, Ndriçim rrugor, Telefoni Lagja Stefanel” kanë rezultuar diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 6,082,193 lekë pa tvsh, ose 14.4 % e kontratës; për 8 zëra punimesh, dhe konkretisht: *Struktura monolite betoni C 12/15 dhe Struktura monolite betoni C 16/20*; *Struktura monolite betoni C 12/15*; *Transport betoni me auto betoniere 3.0 km*; *F.V hekur të zakonshëm*; *Shtresë asfaltobetoni me granil, 4 cm, me makineri*; *Shtresë binderi me gur kave, 6 cm*, si dhe *Gërmim shkëmbi për tubat, (trajtuar më hollësisht në faqet 90-97, të Raport Përfundimtar të Auditimit)*.

8.2 Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **6,082,193 lekë** pa tvsh të përfutur padrejtësisht nga subjekti “S.....” sh.p.k., duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Brenda muajit Mars 2015

9. Gjetje nga auditimi: Nga 4 kompanitë e telefonisë celulare; nuk janë respektuar dispozitat e ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005 “*Për pyjet dhe shërbimet pyjore*”, ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “*Për fondin kullor*”, si dhe VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.6.2006, ndërsa për ato që kanë kaluar nga fondi i tokës bujqësore është UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “*Për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara*”, ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*”, VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*”, si dhe mos likuidimi i detyrimeve për qiranë e sipërfaqes së dhënë në përdorim sipas kontratave të lidhura midis Bashkisë Himarë (përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë) dhe shoqërive të kompanive celulare deri me datë 30.06.2014.

9.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Himarë (Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e MMT, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, Drejtoria Ekonomike dhe Zyra Juridike) të vepohet për rilidhjen e kontratës të qirasë për sipërfaqen e tokës së zënë, si dhe të kërkohet shlyerja e detyrimit dhe eliminimi i mungesës së të ardhurave, pasi subjektet qiramarrëse nuk kanë përmbushur këtë detyrim, duke kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **prej 8,928,539 lekë** (me dëm ekonomik), dhe konkretisht:

Për kompaninë "V...", për vlerën 3,045,832 lekë, nga e cila:

-Vlera prej 591,666 lekë, e kontratës me nr. 365/rep dhe 131/kol, datë 29.03.2002, për sipërfaqen në Dhërmi.

-Vlera prej 1,062,500 lekë, e kontratës me nr. 112/6rep dhe 369/kol, datë 29.09.2002, për sipërfaqen në Hunda e Gjipes.

-Vlera prej 991,666 lekë, e kontratës me nr. 457/rep dhe 156/kol, datë 15.04.2002, për sipërfaqen në Palermo Qeparo.

-Vlera prej 991,666 lekë, e kontratës me nr. 367/rep dhe 112/kol, datë 13.04.2002, për sipërfaqen në Statcioni Himarë.

Për kompaninë "A...", për vlerën 3,422,917 lekë, nga e cila:

-Vlera prej 1,725,000 lekë, e kontratës me nr. 3208/rep dhe 2609/kol, datë 23.09.2009, për sipërfaqen në Maja e Radulit, Pilur.

-Vlera prej 672,917 lekë, e kontratës me nr. 1410/rep dhe 451/kol, datë 27.04.2001, për sipërfaqen në Argjilë Himarë.

-Vlera prej 998,750 lekë, e kontratës me nr. 1669/rep dhe 515/kol, datë 14.05.2001, për sipërfaqen në Sugë Qeparo.

-Vlera prej 26,250 lekë, për qiranë e tokës prej 300 m² rrugë kalimi në fshatin Pilur me gjatësi 250 ml.

Për kompaninë "P..... C ", për vlerën 1,755,000 lekë, nga e cila:

-Vlera prej 585,000 lekë, e kontratës e datës 11.11.2011 protokolluar në Bashki me nr. 1324, datë 21.11.2011, për sipërfaqen në Dhërmi.

-Vlera prej 585,000 lekë, e kontratës e datës 11.11.2011 protokolluar në Bashki me nr. 1324, datë 21.11.2011, për sipërfaqen në Jal.

-Vlera prej 585,000 lekë, e kontratës e datës 11.11.2011 protokolluar në Bashki me nr. 1325, datë 21.11.2011, për sipërfaqen në Palermo.

Për kompaninë "E...", për vlerën 704,790 lekë, nga e cila:

-Vlera prej 155,833 lekë, e kontratës e datës 01.07.2012 për sipërfaqen në zonën e "Qeparo".

-Vlera prej 155,833 lekë, e kontratës e datës 01.07.2012 për sipërfaqen në zonën e "Dhërmi".

-Vlera prej 155,833 lekë, e kontratës e datës 01.07.2012 për sipërfaqen në zonën e "Pilur".

-Vlera prej 155,833 lekë, e kontratës e datës 01.07.2012 për sipërfaqen në zonën e "Jal".

-Vlera prej 81,458 lekë, për mos llogaritje të qirasë për sipërfaqen e marrë në përdorim dhe të pallogaritur me diferencë 50 m².

Brenda muajit Mars 2015

10. Gjetje nga auditimi: Janë paguar padretjesisht 6 punonjës në **vlerën 706,778 lekë**, veprim me shkelje të disiplinës financiare e dëm ekonomik dhe në kundërshtim me lidhjen 2, 5 dhe 6, si dhe pikën 18, të VKM nr. 553 datë, 11.08.2011, ndryshuar me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe nr. 586, datë 17.07.2013, (trajtuar më hollësisht në faqet 43-45, të Raport Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **706,148 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, në ngarkim të 6 punonjësve të Bashkisë Himarë, *më konkretisht:* A.D për vlerën prej 414,742 lekë, R.Z për vlerën prej 139,013 lekë, E.B për vlerën prej 80,290 lekë, B.B për vlerën prej 33,394 lekë, E.B për vlerën prej 27,007 lekë dhe Th.S për vlerën prej 11,702 lekë.

Brenda muajit Mars 2015

11. Gjetje nga auditimi: Janë paguar 15 volejbollistëve dhe 12 punonjësve të administratës së Bashkisë, në vlerën 1,003,800 lekë, shumë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomi, pasi është në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.10.2012 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*”, kapitulli III, pika 1.3 shkronja “b”, paragrafi dytë e tretë, si dhe kapitulli IV, pasi ishin bërë likuidime të këtyre shpenzimeve duke i dhënë dietë të plotë punonjësve në distanca nën 100 km nga qendra e punës, likuidim fjetje pa dokumente tatimor dhe pa faturë të printuar me kasë elektronike, likuidime të transportit pa bileta transporti, të vërtetuara këto:

a-Për ekipin volejbollit femra në 4 raste për 15 volejbolliste me vlerë 707,900 lekë.

b-Për 12 punonjës të administratës në 5 raste me vlerë 295,900 lekë.

11.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,003,800 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, në ngarkim të **15 volejbollistëve dhe 12 punonjësve** të administratës së Bashkisë.

Brenda muajit Mars 2015

12. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste tarifat nuk janë në përputhje me tarifën e vendosur në paketën fiskale të vitit 2012, ku nga 200 lekë/krerë është llogaritur për tarifën 150 lekë/krerë; Në 3 raste tarifat nuk janë në përputhje me tarifën e vendosur në paketën fiskale të vitit 2014, ku nga 120 lekë/krerë është llogaritur për tarifën 110 lekë/krerë; Në 2 raste tarifat nuk janë në përputhje me tarifën e vendosur në paketën fiskale, pasi subjektet me të cilat është lidhur kontrata nuk janë banorë të Bashkisë Himarë; Në 5 raste tarifat e llogaritur sipas kontratës nuk është likuiduar totalisht; dhe Në 6 raste numri i krerëve mbi bazën e së cilës është hartuar dhe nënshkruar kontrata e qirasë nuk përputhet me vërtetimin e raportit veterinar të lëshuar për numrin e krerëve, ku në kontratën e lidhur ky numër është më i vogël se ai i paraqitur në raportin veterinar.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me DMMT, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjyqimit, për arkëtim e të ardhurave të paarkëtuara me (dëm ekonomik) **për vlerën 143,740 lekë**, si më poshtë:

-Në 3 raste, tarifa nuk është në përputhje me paketën fiskale të vitit 2012, ku nga 200 lekë/krerë është llogaritur për tarifën prej 150 lekë/krerë, për vlerën 14,000 lekë, *konkretisht:* S.B për vlerën 5,000 lekë, L.D për vlerën 9,000 lekë.

-Në 3 raste, tarifa nuk është në përputhje me paketën fiskale të vitit 2014, ku nga 120 lekë/krerë është llogaritur për tarifën prej 110 lekë/krerë, për vlerën prej 5,500 lekë, *konkretisht:* N.P për vlerën 2,300 lekë, S.B për vlerën 1,200 lekë dhe L.D për vlerën 2,000 lekë.

-Në 2 raste, tarifa nuk është në përputhje me paketën fiskale, pasi personat nuk janë banorë të kësaj njësie vendore, për vlerën prej 21,000 lekë, *konkretisht:* Sh.Xh në vlerën 3,000 lekë dhe P.S në vlerën 18,000 lekë.

-Në 4 raste, tarifa e likuiduar e qirasë nuk është sipas vlerës së kontratës për vlerën prej 59,400 lekë, *konkretisht:* H.B për vlerën 20,000 lekë, F.L. për vlerën 2,200 lekë, J.M për vlerën 37,200 lekë.

-Në 6 raste, numri i krerëve mbi bazën e së cilës është hartuar dhe nënshkruar kontrata e qirasë nuk përputhet me vërtetimin e raportit veterinar të lëshuar për numrin e krerëve, për vlerën prej 43,840 lekë, *konkretisht:* S.L për vlerën 13,000 lekë, Th.T për vlerën 1,200 lekë, N.P për vlerën 8,400 lekë, J.B për vlerën 9,240 lekë dhe L.D për vlerën 12,000 lekë.

Brenda muajit Mars 2015

13. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, tarifa e llogaritur sipas kontratës së shërbimit për bimë medicinale nuk është likuiduar e plotë sipas vlerës së llogaritur në kontratë, dhe Në 38 raste, detyrimi për qiranë e llogaritur për sipërfaqet e shfrytëzueshme për grumbullimin bimëve medicinale, nuk është në përputhje me tarifën e përcaktuar në VKB nr. 156, datë 05.12.20013, pika 6-Tarifa për qiranë e kullotave për blegtorinë dhe bimëve medicinale, i cili paraqitet për vlerën 12,000 lekë.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me DMMT, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore dhe të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtim e të ardhurave të paarkëtuara me (dëm ekonomik) për **vlerën 269,600 lekë**, si më poshtë:

-Në 2 raste, tarifa e likuiduar e qirasë nuk është sipas vlerës së kontratës për vlerën prej 8,400 lekë, *konkretisht:* J.Th për vlerën 4,400 lekë dhe Gj.B për vlerën 4,000 lekë.

-Në 38 raste, tarifa nuk është në përputhje me paketën fiskale të VKB nr. 156, datë 05.12.2013, ku nga 12,000 lekë/ha është llogaritur për vlerën 8.000 lekë/ha, për vlerën prej 261,600 lekë.

Brenda muajit Mars 2015

14. Gjetje nga auditimi: Bashkia Himarë bazuar në Aktin Normativ të KM nr. 1, datë 6.2.2013 “Për pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar”(Miratuar me ligjin nr.96/2013, datë 04.03.2013) ka miratuar dhe zbardhur 7 leje zhvillimore.

Pas shqyrtimit të lejeve të ndërtimit, ashtu dhe lejeve të zhvillimit sipas aktit normativ për shtesat dhe volumet pa leje, u konstatua se lejet e ndërtimit janë dhënë sipas Studimeve Urbanistikë Pjesor (SUP) të cilat nuk respektojnë hartimin dhe përmbajtjen e një SUP, në kundërshtim me pikat 46, 47 dhe 48 të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për Miratimin e Rregullores së Urbanistikës” të ndryshuar dhe ato nuk bazohen në një Plan Rregullues të Përgjithshëm, në kundërshtim me pikat 43, 44 dhe 45 të kësaj rregulloreje.

Lejet e zhvillimit sipas aktit normativ për shtesat pa leje nuk janë dhënë sipas Formularit TIP 2, në kundërshtim me VKM nr. 502, datë 13.07.2011, duke ju shmangur kështu detyrimit të përcaktimit të të dhënave të përgjithshme dhe kondicioneve teknike në leje, ato janë dhënë për të gjithë objektin dhe jo vetëm për sipërfaqen e ndërtuar pa leje, e cila është sipërfaqja që pajiset me leje zhvillimore sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 06.02.2013.

Nga Bashkia Himarë është përlllogaritur gabim taksa 4% e lejeve të ndërtimit, e lejeve të zhvillimit për shtesat pa leje në objekte me leje si edhe është miratuar kërkesa për këto të fundit pa dokumentin që vërteton pagesën e gjobës konform nenit 82 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, duke i shkaktuar buxhetit të njësisë vendore një dëm ekonomik në vlerën **10,379,302 lekë**, .

14.1 Rekomandim: Nga Bashkia Himarë të merren masat për të kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin nga 4 subjekte të vlerës prej **10,379,302 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shkaktuar si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të taksës së lejeve të ndërtimit, të lejeve të zhvillimit për shtesat pa leje në objekte me leje si edhe mos arkëtimin të gjobës, nga subjektet ndërtuese, si më poshtë:

1. Vlera **378,807** lekë subjektit “A...S” sh.p.k për llogaritje të gabuar të taksës 4% të lejes së zhvillimit dhënë sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 06.02.2013 për shtesat pa leje në objekte me leje.

2. Vlera **2,319,558** lekë subjektit “A..S” sh.p.k për dënimin me gjobë për shtesat pa leje në ndërtimet me leje konform nenit 83, pika 6 dhe nenit 82 pika 7, të ligjit 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin të Territorit”, të ndryshuar.

3. Vlera **751,684** lekë subjektit “R.....” sh.p.k për llogaritje të gabuar të taksës 4% të lejes së ndërtimit.

4. Vlera **44,866** lekë subjektit “R.....” sh.p.k për llogaritje të gabuar të taksës 4% të lejes së zhvillimit dhënë sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 06.02.2013 për shtesat pa leje në objekte me leje.

5. Vlera **2,463,864** lekë subjektit “R...” sh.p.k për dënimin me gjobë për shtesat pa leje në ndërtimet me leje konform nenit 83, pika 6 dhe nenit 82 pika 7, të ligjit 10119, datë 23.04.2009.

6. Vlera **229,049** lekë subjektit “P...” sh.p.k për llogaritje të gabuar të taksës 4% të lejes së ndërtimit.

7. Vlera **48,644** lekë subjektit “P...” sh.p.k për llogaritje të gabuar të taksës 4% të lejes së zhvillimit dhënë sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 06.02.2013 për shtesat pa leje në objekte me leje.

8. Vlera **3,000,860** lekë subjektit “P...” sh.p.k për dënimin me gjobë për shtesat pa leje në ndërtimet me leje konform nenit 83, pika 6 dhe nenit 82 pika 7, të ligjit 10119, datë 23.04.2009.

9. Vlera **26,914** lekë subjektit “S.....D” sh.p.k për llogaritje të gabuar të taksës 4% të lejes së zhvillimit dhënë sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 06.02.2013 për shtesat pa leje në objekte me leje.

10. Vlera **1,115,056** lekë subjektit “S...D” sh.p.k për dënimin me gjobë për shtesat pa leje në ndërtimet me leje konform nenit 83, pika 6 dhe nenit 82 pika 7, të ligjit 10119, datë 23.04.2009.

Certifikata e Përdorimit, për objektet e sipërcituara të miratohet vetëm pas arkëtimit të gjobave dhe vlerës së papaguar të taksave të lejeve të ndërtimit e zhvillimit.

Brenda muajit Mars 2015

15. Gjetje nga auditimi: Për 199 persona të cilat janë pajisur me AMTP për një sipërfaqe prej 478065 m², nuk është bërë i mundur llogaritja e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore për periudhën objekt auditimi, veprime në kundërshtim me nenin 23, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e Taksave Vendore*”, i ndryshuar”.

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të marrë masat për llogaritjen e detyrimeve të taksës së tokës bujqësore të **199 personave** të cilat janë pajisur me AMTP për sipërfaqen prej 478065 m², si dhe të nxirret njoftim vlerësimit në zbatim të nenit 70, pika 3-e drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, për **shumën 258,155 lekë** (dëm ekonomik), për periudhën 3-vjeçare.

Brenda muajit Mars 2015

16. Gjetje nga auditimi: Për 20 subjekte nuk është bërë i mundur llogaritja dhe arkëtimi i detyrimeve që rrjedhin nga taksa e reklamës, veprime në kundërshtim me nenin 23/1, shkronja “iii” e lidhjes 7, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006, i ndryshuar.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat për evidentimin e subjekteve që disponojnë reklama, si dhe të llogarisë dhe arkëtojë detyrimet për taksën e reklamës të **20 subjekte**, duke nxjerrë njoftim vlerësimit, për **shumën 3,189,375 lekë** (dëm ekonomik), për periudhën 3-vjeçare.

Brenda muajit Mars 2015

17. Gjetje nga auditimi: Detyrimi për taksën e ndërtesës nuk është llogaritur sipas të dhënave të disponueshme në këtë njësi vendore, pasi evidentohen raste ku taksa e ndërtesës nuk është llogaritur për sipërfaqen në përdorim dhe llojin e funksionit të objektit, veprime këto në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006, i ndryshuar.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masat për:

- evidentimin, saktësimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksës së ndërtesës për **41 subjekte**, duke nxjerrë njoftim vlerësimit në zbatim të nenit 70, pika 3-e drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, për **shumën 8,459,151 lekë** (dëm ekonomik), pasqyra **Aneks 17 e 18**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- evidentimin, saktësimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksës së ndërtesës për **87 abonentë familjarë**, duke nxjerrë njoftim vlerësimit në zbatim të nenit 70, pika 3-e drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, për **shumën 688,296 lekë** (dëm ekonomik), pasqyra **Aneks 3**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Mars 2015

18. Gjetje nga auditimi: Nuk është bërë e mundur llogaritja e detyrimeve për taksën e fjetjes në hotel të subjekteve të cilët ushtrojnë aktivitetet hotelierie ose dhomave me qira në periudhën e sezonit turistik. Gjithashtu ka raste ku megjithëse subjektet kanë qenë të regjistruar në vitin 2012 në DTTV Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, për vitet 2013 – 2014 këto subjekte nuk rezultojnë të regjistruar, duke bërë që ndajë këtyre subjekteve të mos aplikohen detyrimet që rrjedhin nga taksat e tarifave vendore, veprime të cilat pikën 4 të nenit 12 dhe nenin 26, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006, me ndryshime, dhe nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, me ndryshime.

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat për evidentimin e subjekteve që disponojnë hotele dhe dhoma me qira, si dhe të llogarisë dhe arkëtojë detyrimet për hapësirën e shfrytëzuar dhe patakshuar të **318 subjekte**, duke nxjerrë njoftim vlerësimit, **për dëmin ekonomik në vlerën 18,663,750 lekë**, sipas pasqyrës Aneks nr. 4.

Brenda muajit Qershor 2015

18.2. Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat për evidentimin e subjekteve të cilët kanë qenë aktiv në periudhën e vitit 2012 dhe nuk rezultojnë të reregjistruar në vitet 2013 - 2014, si dhe të llogarisë dhe arkëtojë detyrimet për hapësirën e shfrytëzuar dhe patakshuar për mos zbatim të kushteve të kontratave të qirasë për **15 subjekte**, duke nxjerrë njoftim vlerësimit në zbatim të nenit 70, pika 3-e drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, **për dëmin ekonomik në vlerën 2,361,388 lekë**, sipas pasqyrës Aneks nr. 5.

Brenda muajit Mars 2015

19. Gjetje nga auditimi: Disa subjekte të cilët kanë qenë aktiv në vitin 2012, për vitet 2013-2014 rezultojnë të paregjistruar, duke bërë që ndajë këtyre subjekteve të mos aplikohen detyrimet që rrjedhin nga taksat e tarifat vendore. Gjithashtu referuar të dhënave të regjistrimit “*Mbi sipërfaqet e objekteve të ndërtimit*”, hartuar nga Drejtoria e Planifikim Kontrolli dhe Zhvillimit të Territorit (ish-Drejtor Urbanistikës) rezulton se, për disa persona është evidentuar se objekti i ndërtimit që ka në administrim ka funksion tregtar/shërbimi, por që nuk është bërë i mundur llogaritja e detyrimeve për taksat e tarifat vendore që rrjedhin nga aktivitetit që ato ushtrojnë, duke krijuar evazion fiskal në dëm të buxhetit të Bashkisë Himarë dhe të buxhetit qendrorë për efekt të mos llogaritjes e derdhjes së detyrimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësorë, veprime në kundërshtim me nenin 4 dhe 22, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006, i ndryshuar dhe nenin 32 dhe 40 të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008.

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat për evidentimin e subjekteve të cilët kanë qenë aktiv në periudhën e vitit 2012 dhe nuk rezultojnë të reregjistruar në vitet 2013-2014 për të cilën nuk janë aplikuar detyrimet fiskale, si dhe të llogarisë dhe arkëtojë detyrimet për taksat e tarifat vendore të patakshuar për **44 subjekte**, duke nxjerrë njoftim vlerësimit në zbatim të nenit 70, pika 3-e drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, **vlerën 8,479,204 lekë** (dëm ekonomik), sipas pasqyrës Aneks nr. 8, 9, 10, 11 e 12, bashkëlidhur raportit.

Brenda muajit Mars 2015

20. Gjetje nga auditimi: Disa subjekteve janë klasifikuar me status “*mbyllje aktiviteti*”, por nga auditimi i dosjeve të këtyre subjekteve dhe procedurat e ndjekura nga kjo administratë për klasifikimin e tyre me status mbyllje, rezulton se këto subjekte nuk plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 44, pikat 1, 2, 3, 4, dhe 5, neni 45, pikat 2, 5, 6, 7, 8, dhe 9, nenin 60, pika 2, dhe 3, shkronjat a dhe b neni 69, pikat 1, 2, 3 dhe 4, me kreun e IX neni 74, kreu XI, neni 88, 90, 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, dhe pikat 2.4, 3.1, 8,10 dhe 11, të Udhëzimit të përbashkët të MF dhe MB nr, 655/1 datë 06.02.2007 “*Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe raportimit të sistemit të taksave vendore*”

20.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat për kontrollin e subjekteve të cilët kanë deklaruar mbyllje aktivitetit, si dhe të llogarisë dhe arkëtojë detyrimet për taksat e tarifat vendore të patakshuar për **13 subjekte**, duke nxjerrë njoftim vlerësimit në zbatim të nenit 70, pika 3-e drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, **për vlerën 471,864 lekë**.

Brenda muajit Mars 2015

21.Rekomandim: Nga Bashkia Himarë, për subjektet debitore ndaj njësisë vendore, të cilat kanë krijuar dëm ekonomik apo të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit dhe refuzojnë të përmbushin detyrimin, të dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, veprime bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”.

Në rast se subjektet edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Banke dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, pasi tu vendosen masa administrative (*gjobë në masën 25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008*), të kërkohej kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, pikat 130-132 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, i ndryshuar dhe Kodit Penal, neni 181, “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*”.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës neni 9-*masat disiplinore*, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë, që bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 23 punonjësit, si më poshtë:

C/I “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, neni 9 shkronja “b”, të kontratës individuale.

- 1. Znj. B.B.**, me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Taksave, në cilësinë e cilësinë e anëtarit të komisionit për periudhën e 6 mujorit të dytë 2011.
- 2. Znj. R.Z.**, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Personelit dhe Kabinetit të Kryetarit, në cilësinë e anëtarit të komisionit për vitin 2012.
- 3. Z. O.G.**, me detyrë Përgjegjëse Sektorit (Zyra pyje, kullota AMC), në cilësinë e anëtarit të komisionit për periudhën e 3 mujorit të IV të vitit 2012.
- 4. Z. Th.S.**, me detyrë specialist i lartë i procedurës administrative (zyra juridike), në cilësinë e anëtarit të komisionit për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014.

Për mangësi të konstatuara në:

Prokurimet me vlerë të vogël për blerje materiale dhe kryerje shërbimesh, në **24 raste me vlerë 6,258,638 lekë**, veprime në kundërshtim me shkronjën “ç”, pika 2, kreu VI^{-të}, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Veprime këto të kryera në periudhën e 6 mujorit e dytë të viti 2011 dhe likuiduara në vitin 2012. Për blerjet e kryera në vitin 2012, si dhe për blerjet e shërbimet e kryera për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë 2014.

5. Z. S.K., me detyrë specialist i lartë ndërtimi (Drejtorja e Shërbimeve), në cilësinë e anëtarit të komisionit për inventarizimin e aseteve.

6. Z. S.M., me detyrë përgjegjës sektori në Drejtorinë e MMT, në cilësinë e anëtarit të komisionit për inventarizimin e aseteve.

Për mangësi të konstatuara në:

Mos zbatim të urdhrit nr. 40, datë 27.03.2013 të Kryetarit të Bashkisë, për kryerjen e inventarizimit e plotë të pasurisë së paluajtshme publike, pronë e Bashkisë Himarë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe pikat 9,10 e 13, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

7. Z. E.M., me detyrë specialist i lartë topografie në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të komisionit për inventarizimin e aseteve, *për mangësi të konstatuara:*

Mos zbatim të urdhrit nr. 40, datë 27.03.2013 të Kryetarit të Bashkisë, për kryerjen e inventarizimit e plotë të pasurisë së paluajtshme publike, pronë e Bashkisë Himarë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe pikat 9,10 e 13, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 1 procedurë të marrjes në dorëzim të investimit “*Rikonstrukcion rrugë të brendshme, Ujësjiellës, KUZ, KUB, Ndriçim rrugor, Telefoni Lagja Stefanel*” realizuar nga “Salillari” sh.p.k. me dëm ekonomik në vlerën prej **6,082,193 lekë pa tvsh, ose 14.4 % e kontratës**, si pasojë e pagesave të paligjshme dhe të pamerituara, të përfutur nga përllogaritja dhe likuidimi i punimeve të situacionuara por të pa realizuara në fakt, veprim në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”

8. Z. I.GJ, me detyrë Nënkryetar i Bashkisë Himarë, në cilësinë e ish-Drejtorit të Taksave e Tarifave Vendore, *për mangësi të konstatuara*:

- Mungesë kontrolli ndaj vartësve lidhur me, mos-rakordimin e të dhënave me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë (Biznesin e Madh), Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor (taksën e regjistrimit automjeteve) dhe ZVRPP Vlorë (kalimi i së drejtës së pronësisë), për transaksionet e ndryshme që subjektet fizike kryejnë, etj.

- Nuk janë zbatuar procedurat për arkëtimin e detyrimeve të pambledhura në shumën totale 87,783,240 lekë, nga e cila; taksë nga ndërtesat 5,001,120 lekë, taksë për token bujqësore 9,271,000 lekë, taksë hoteli 8,242,000 lekë, taksë për zënie hapësire publike 65,269,120 lekë.

- Moszbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KLSH dhe konkretisht për 8 masa organizative të cilat nuk janë zbatuar.

- Nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin për shpërblim dëmi sipas rekomandimeve të KLSH në shumën 28,947,094 lekë, të kontabilizuar, nga këto:

- Nuk janë nxjerr njoftime në 16 raste në shumën 14,257,212 lekë, pasi urdhër njoftimi është nxjerr vetëm për 15 raste në shumën 14,689,882 lekë nga këto, duke u arkëtuar vetëm 240,115 lekë dhe mbetur pa u arkëtuar shuma 28,706,979 lekë.

- Nuk ka asnjë praktikë lidhur me procedurat për arkëtimin e detyrimeve prej secilit debitor.

- Nuk ka marrë masa për subjektet debitorë për pagesën e detyrimeve, dhe listat e debitorëve nuk i ka dërguar zyrtarisht në Policinë Bashkiake, si dhe nuk i është kërkuar Këshillit Bashkiak Himarë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”.

- Nuk janë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për subjekte debitorë në zbatim të nenit 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat tatimore*”. Nuk ka vazhduar procedura për ndjekjen e debitorëve në të gjitha etaprat, në zbatim të ligjit.

- Veprimet dhe mosveprimet në kryerjen e detyrës së tij funksionale, mangësi në organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Taksave Vendore dhe mungesës së kërkesës së llogarisë ndaj vartësve në punën e të cilëve u konstatuan shkelje të dispozitave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06/02/2007 “*Për përcaktimin e uniformi tetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore*”, ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “*Për Procedurat Tatimore*” dhe Kreut V, të Rregullores së Brendshme të Bashkisë, në realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore për vitin 2013.

9. Z. TH.L, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, *për mangësi të konstatuara*:

- VKM nr. 997, datë 10.10.2010 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*”, ku ka likuiduar 15 volibollisit shpenzimet për fjetje *pa faturë tatimore dhe kupon lëshuar me kasë elektronike*, si dhe 12 punonjësve të administratës dietë e plotë në distanca nën 100 km, me efekt financiar prej **340,000 lekë**

- Shkronjën “dh” dhe “e”, të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, si dhe nenin 35, shkronja “a, b, c”, nenin 36, të UNF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin financiare të aktiveve në sektorin publik*”, është bërë likuidimin e faturës nr. 89, datë 11.04.2013, të OE “AEK and CO”, me efekt financiare në dëm të buxhetit prej 4,859,274 lekë.

-Nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin për shpërblim dëmi sipas rekomandimeve të KLSH në shumën 28,947,094 lekë, të kontabilizuara, nga këto:

-Nuk janë nxjerr njoftime në 16 raste në shumën 14,257,212 lekë, pasi urdhër njoftimi është nxjerr vetëm për 15 raste në shumën 14,689,882 lekë nga këto, duke u arkëtuar vetëm 240,115 lekë dhe mbetur pa u arkëtuar shuma 28,706,979 lekë.

-Nuk ka asnjë praktikë lidhur me procedurat për arkëtimin e detyrimeve prej secilit debitor.

-Nuk ka marrë masa për subjektet debitorë për pagesën e detyrimeve, dhe listat e debitorëve nuk i ka dërguar zyrtarisht në Policinë Bashkiake, si dhe nuk i është kërkuar Këshillit Bashkiak Himarë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

- Nuk janë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për subjekte debitorë në zbatim të nenit 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”. Nuk ka vazhduar procedura për ndjekjen e debitorëve në të gjitha etapat, në zbatim të ligjit.

-Mungesë kontrolli ndaj vartësve lidhur me, mos-rakordimin e të dhënave me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë (Biznesin e Madh), Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor (taksën e regjistrimit automjeteve) dhe ZVRPP Vlorë (kalimi i së drejtës së pronësisë), për transaksionet e ndryshme që subjektet fizike kryejnë, etj.

-Veprimet dhe mosveprimet në kryerjen e detyrës së tij funksionale, mangësi në organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Taksave Vendore dhe mungesës së kërkesës së llogarisë ndaj vartësve në punën e të cilëve u konstatuan shkelje të dispozitave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06/02/2007 “Për përcaktimin e uniformi tetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore” dhe Kreut V, të Rregullores së Brendshme të Bashkisë, në realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore për periudhën e 6 muorit të parë 2014.

10. Znj. B.R., me detyrë inspektore regjistrim procedurash në Drejtorinë e Taksave Vendore, *për mangësi të konstatuara:*

-Mos njoftim të abonentëve familjarë, mbi detyrimet e taksat/tarifatat vendore të ndërtimit, pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe tokës bujqësore, në kundërshtim me nenin 12, pika 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, dhe nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

-Mos zbatim të procedurave të parashikuara në Kreu XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara, i ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, pikat 3 dhe 5, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Financave dhe MPVD nr. 5, datë 27/01/2003; pikat 4. nënpikat 4.1.4.3, pikat 5, 6, 8 dhe 9, e udhëzimit të MF nr. 655/1, datë 06/02/2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”; nenin 17 dhe neni 34, shkronja “a”, pika 3, për arkëtimin e detyrimeve të subjekteve fizik dhe juridik.

11. LL.LL., me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, *për mangësi të konstatuara:*

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 1 procedurë të marrjes në dorëzim të investimit “Rikonstruksion rrugë të brendshme, Ujësjiellës, KUZ, KUB, Ndriçim rrugor, Telefoni Lagja Stefanel” realizuar nga “Salillari” sh.p.k. me dëm ekonomik në vlerën prej **6,082,193 lekë pa tvsh, ose 14.4 % e kontratës**, si pasojë e pagesave të paligjshme dhe të pamerituara, të përfituar nga përlllogaritja dhe likuidimi i punimeve të situacionuara por të pa realizuara në fakt, veprim në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”

C/III “Zgjidhja e kontratës së punës”, neni 9 shkronja “c”, e kontratës individuale.

1. Z. K.K., me detyrë inspektor vlerësimi dhe kontrollit në terren në Drejtorinë e Taksave Vendore, *për mangësi të konstatuara në:*

-Mos kryerja e kontrolleve lidhur me, rakordimin e të dhënave me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë (Biznesin e Madh), Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor (taksën e regjistrimit automjeteve) dhe ZVRPP Vlorë (kalimi i së drejtës së pronësisë), për transaksionet e ndryshme që subjektet fizike kryejnë, etj.

-Mos njoftim të subjekteve fizik, mbi detyrimet e taksat/tarifat vendore të ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, biznesit të vogël dhe gjobat për mos likuidim të detyrimeve, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e Taksave Lokale”, ime ndryshime dhe nenit 32, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore” me ndryshime.

-Mos taksim të subjekteve fizik për taksat/tarifat vendore, në kundërshtim me nenin 12, pika 4, e ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime dhe nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime, kjo evidentuar për;

a) Taksën e Reklamës në 20 subjekte me vlerë 3,189,375 lekë;

b) Taksën e ndërtesës;

-në 109 objekte të pajisura me leje zhvillimi/përdorimi me vlerë 6,778,391 lekë.

-në 19 subjekte të regjistruara, por për të cilët nuk është llogaritur detyrimi në vlerën 2,349,056 lekë;

c) Taksa e fjetjes në hotel;

-në 318 subjekteve të paregjistruara me vlerë 18,663,750 lekë;

-në 15 subjekte të cilët kanë qenë aktiv në vitin 2012 dhe për vitet 2013-2014 nuk rezultojnë të reregjistruar me vlerë 2,361,388 lekë;

d) Taksa e biznesit të vogël;

-në 25 subjekte të evidentuar si subjekte aktiv, por ndajë të cilëve nuk është aplikuar detyrimi për taksat/tarifat në vlerën 7,314,684 lekë;

-në 19 subjekte të cilët kanë qenë aktiv në vitin 2012 dhe për vitet 2013-2014 nuk rezultojnë të reregjistruar me vlerë 1,164,520 lekë;

-Mos zbatim të procedurave të parashikuara në Kreu XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara, i ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, pikat 3 dhe 5, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Financave dhe MPVD nr. 5, datë 27/01/2003; pikat 4. nën-pikat 4.1.4.3, pikat 5, 6, 8 dhe 9, e udhëzimit të MF nr. 655/1, datë 06/02/2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”; nenin 17 dhe neni 34, shkronja “a”, pika 3, për arkëtimin e detyrimeve të subjekteve fizik dhe juridik.

-Në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin me objekt ‘Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë’ viti 2013, në kundërshtim me nenin 12-përgjegjësia e AK, nenin 52-hapja e ofertave, neni 53-shqyrtimi i ofertave, pika 4 e nenit 55-kriteret e përcaktimit të ofertës fitues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar, si dhe pikës 4, shkronjat “a,b,c,q,d dhe i”, kreu V, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshua, nuk është ndjekur asnjë procedurë shkresore, për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sepse nuk është mbajtur asnjë procesverbal për këtë procedurë.

2. Z. E.R., me detyrë inspektor i regjistrimit të procedurave në Drejtorinë e Taksave Vendore, *për mangësi të konstatuara në:*

-Mos kryerjen e kontrolleve në subjektet fizike dhe juridik, për monitorimin e xhiros së subjekteve, evidentimin hapësirave publike të zëna, sipërfaqen e ndërtimit me gent-plan, sipërfaqeve të reklamave, mbajtjen e librit të xhiros, regjistrimit të faturave etj, në kundërshtim me

pikës 10 “*Kontrolli tatimor*”, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 6/2/2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

-Mos zbatim të procedurave të parashikuara në Kreu XI-*Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara*, i ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, pikat 3 dhe 5, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Financave dhe MPVD nr. 5, datë 27.01.2003; pikat 4. nënpikat 4.1.4.3, pikat 5, 6, 8 dhe 9 e udhëzimit të MF nr. 655/1, datë 06/02/2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”; nenin 17 dhe neni 34, shkronja “a”, pika 3, për arkëtimin e detyrimeve të subjekteve fizik dhe juridik.

-Mos evidentim të subjekteve fizik që ushtrojnë aktivitet në juridiksionin e kësaj Njësie Vendore, për aplikimin e detyrimeve që rrjedhin nga taksat/tarifat vendore, në kundërshtim me nenin 12, pika 4, e ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime dhe nenin 40, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime, *kjo evidentuar për*;

a) Taksën e Reklamës në 20 subjekte me vlerë 3,189,375 lekë;

b) Taksën e ndërtesës;

-në 19 subjekte të regjistruara, por për të cilët nuk është llogaritur detyrimi në vlerën 2,349,056 lekë;

c) Taksa e fjetjes në hotel;

-në 318 subjekteve të paregjistruara me vlerë 18,663,750 lekë;

-në 15 subjekte të cilët kanë qenë aktiv në vitin 2012 dhe për vitet 2013-2014 nuk rezultojnë të reregjistruar me vlerë 2,361,388 lekë;

d) Taksa e biznesit të vogël;

-në 25 subjekte të evidentuar si subjekte aktiv, por ndajë të cilëve nuk është aplikuar detyrimi për taksat/tarifat në vlerën 7,314,684 lekë;

-në 19 subjekte të cilët kanë qenë aktiv në vitin 2012 dhe për vitet 2013-2014 nuk rezultojnë të reregjistruar me vlerë 1,164,520 lekë;

Në cilësinë e Kryetarit të KVO, në tenderin me objekt ‘Pastim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë’ viti 2014, në kundërshtim me nenin 12-*përgjegjësia e AK*, nenin 52-*hapja e ofertave*, neni 53-*shqyrtimi i ofertave*, pika 4 e nenit 55-*kriteret e përcaktimit të ofertës fitues*, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar, si dhe pikës 4, shkronjat “a,b,c,ç,d dhe i”, kreu V, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshua, në drejtim të hartimit të procedurë shkresore dhe shpalljes së OE fitues.

- Prokurimet me vlerë të vogël për blerje materiale dhe kryerje shërbimesh, në 10 raste me vlerë 1,991,138 lekë, veprime në kundërshtim me shkronjën “ç”, pika 2, kreu VI^{të}, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Veprime këto të kryera në periudhën e viti 2013 dhe 6 mujorin e parë 2014.

3. Z. J.B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, *për mangësi të konstatuara në*:

-Kontratat për kullotë për;

a)mos protokollim në zyrën e arkivit të bashkisë, në kundërshtim me nenin 39 shkronja f, nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar;

b)mos dokumentim shkresor, lidhur me miratimin nga Këshilli i Bashkisë të dhënies me qira të sipërfaqes dhe konfirmimi nga Prefekti;

c)mungesë dokumentacioni shoqërues për marrjen me qira për kullotje nga personat e ndryshëm, veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr. 9693, datë 19/03/2007 “Për fondin kollusor” dhe pikën 3 dhe 4, të udhëzimit nr. 4, datë 10/04/2008;

d)mos shpallje të listave për kullotat e gatshme për kullotje dhe kositje brenda muajt shkurt të çdo viti, siç përcaktohet në VKM nr. 162, datë 07.07.2007, ndryshuar me VKM nr. 1712, datë 24.12.2008, VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe pikën 12, të udhëzimit nr. 4, datë 10/04/2008, duke përcaktuar zonën e kullotës dhe lloj e ekonomisë për kullotje;

e)në 8 raste, ku tarifa e aplikuar nuk është në përputhje me paketën fiskale të vitit 2012 dhe 2014, ku nga 200 lekë/krerë është llogaritur për tarifën prej 150 lekë/krerë, apo nga 120 lekë/krerë është llogaritur për tarifën prej 110 lekë/krerë duke sjellë mungesë të ardhurash në Bashkinë Himarë prej 40,500 lekë;

f)në 4 raste, tarifa e llogaritur sipas kontratës së qirasë nuk është likuiduar e plotë sipas vlerës së llogaritur, duke lënë pa arkëtuar vlerën prej 59,400 lekë;

m)në 6 raste, numri i krerëve mbi bazën e së cilës është hartuar dhe nënshkruar kontrata e qirasë nuk përputhet me vërtetimin e raportit veterinar të lëshuar për numrin e krerëve, ku në kontratën e lidhur ky numër është më i vogël se ai i paraqitur në raportin veterinar, veprime të cilat kanë bërë që llogaritja e tarifës së qirasë të mos jetë e saktë për vlerën prej 43,840 lekë;

-Kontratat e grumbullimit të bimëve medicinale, për;

a)mos dokumentim shkresor, lidhur me miratimin nga Këshilli i Bashkisë të dhënies me qira të sipërfaqes dhe konfirmimi nga Prefekti;

b)mungesë dokumentacion mbi kërkesat paraprake të paraqitura nga subjektet private, mungesa e procesverbalit të mbledhjes me shqyrtimin e kërkesave, si dhe vendim i pranimit ose jo së bashku me arsyet e mospranimit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 162, datë 07.07.2007, ndryshuar me VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 dhe VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”;

c)mungesa e procesverbalit të marrjes në dorëzim të sipërfaqes ku do të zhvillohet veprimtaria dhe dorëzimi i tij, si dhe nuk evidentohen sasia dhe llojet e bimëve që grumbullohen, veprim në kundërshtim me Kreu III, neni 25, të ligjit nr. 10120, datë 23.4.2009;

d)mos ushtrimin e kontroleve në sipërfaqet e marra me qira, mbi lloj dhe sasinë e bimëve të grumbulluara dhe sipërfaqen e shfrytëzuar, veprim në kundërshtim me nenin 31, të ligjit nr. 10120, datë 23.4.2009;

e)mungesa e treguesit sasiorë, cilësorë për lloj e bimëve që do të grumbullohen të cilët janë të nevojshëm për përcaktimin e tarifës, si dhe nuk është realizuar programi i monitorimit si një proces i përhershëm dhe i detyrueshëm;

f)mos aplikim të saktë të çmimit të kontratës në referencë të VKM nr. 530 datë 21.8.1998, neni 13, Pasqyra nr. 2;

-Në 38 raste, detyrimi për qiranë e llogaritur për sipërfaqet e shfrytëzueshme për grumbullimin bimëve medicinale, nuk është në përputhje me tarifën e përcaktuar në Vendimin e KB nr. 156, datë 05.12.20013, pika 6-*Tarifa për qiranë e kullotave për blegtorinë dhe bimëve medicinale*, i cili paraqitet për vlerën 12,000 lekë, veprime të cilat kanë bërë që llogaritja e tarifës së qirasë të mos jetë e saktë për vlerën prej 261,600 lekë;

-Pajisjen e personave me AMTP pa dokumentacion ligjorë mbi titullin e pronësisë së pronën, veprime në kundërshtim me VKM nr. 253 datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativës bujqësore” dhe ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, *trajtuar në faqen 156-184, të raport auditimit*.

-Pajisjen e disa personave me sipërfaqe toke më të madhe se sipërfaqja e evidentuar nga Kryesia e Fshatit Gjilekë, veprime në kundërshtim me pikën 8, të VKM nr. 253 datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativës bujqësore”.

-Në një rast megjithëse personi ishte pajisur me AMTP në vitin 1996, nga Drejtoria e AMMT Bashkia Himarë është pajisur me AMTP të re, veprim në kundërshtim me VKM nr. 253, datë 06.03.2013, pika 4 shkronja a, *trajtuar në faqen 156-184, të raport auditimit*.

-Pajisjen e personave me AMTP me dokumentacion të parregullt dhe në kundërshtim me VKM nr. 253, datë 06.03.2013,

-Në 14 raste sipërfaqja e plotësuar në AMTP është më e madhe se sipërfaqja e miratuar me VKB nr. 158, datë 05.12.2013, të konfirmuar nga Kryesia e fshatrave dhe dokumentacioni tjetër ligjor, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", ligjin nr. 58/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, VKM nr. 253 datë 06.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativës bujqësore".

-Në 2 raste AMTP janë dhënë në kundërshtim me shkronjën "e" të nenit 14 dhe neni 18, të ligjit nr. 58/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, dhe pikës 13, të VKM nr. 253 datë 06.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativës bujqësore".

4. Z. V.L, me detyrë përgjegjës i Zyrës Juridike, *për mangësi të konstatuara në:*

-Kundërshtim me nenin 12-përgjegjësia e AK, nenin 52-hapja e ofertave, neni 53-shqyrtimi i ofertave, pika 4 e nenit 55-kriteret e përcaktimit të ofertës fitues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimet Publike", i ndryshuar, si dhe pikës 4, shkronjat "a,b,c,ç,d dhe i", kreu V, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshua, nuk është ndjekur asnjë procedurë shkresore, për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sepse nuk është mbajtur asnjë procesverbal për këtë procedurë. Nuk kanë bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KLSH-ja

-Moszbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KLSH dhe konkretisht për 8 masa organizative të cilat nuk janë zbatuar.

-Nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin për shpërblim dëmi sipas rekomandimeve të KLSH në shumën 28,947,094 lekë, të kontabilizuara, nga këto:

-Nuk ka asnjë praktikë lidhur me procedurat për arkëtimin e detyrimeve prej secilit debitor.

-Nuk ka marrë masa për subjektet debitorë për pagesën e detyrimeve, dhe listat e debitorëve nuk i ka dërguar zyrtarisht në Policinë Bashkiake, si dhe nuk i është kërkuar Këshillit Bashkiak Himarë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja "ç" nën-pika "iii", të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

-Nuk janë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për subjekte debitorë në zbatim të nenit 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore". Nuk ka vazhduar procedura për ndjekjen e debitorëve në të gjitha etapat, në zbatim të ligjit.

-Në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin me objekt 'Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë' viti 2013, në kundërshtim me nenin 12-përgjegjësia e AK, nenin 52-hapja e ofertave, neni 53-shqyrtimi i ofertave, pika 4 e nenit 55-kriteret e përcaktimit të ofertës fitues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimet Publike", i ndryshuar, si dhe pikës 4, shkronjat "a,b,c,ç,d dhe i", kreu V, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshua, nuk është ndjekur asnjë procedurë shkresore, për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sepse nuk është mbajtur asnjë procesverbal për këtë procedurë.

5. A.B, me detyrë Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Godinave, në cilësinë e Kryetarë të KVO, në tenderin me objekt 'Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë', viti 2013 (Kryetar i KVO), *për mangësi të konstatuara në:*

-Kundërshtim me nenin 12-përgjegjësia e AK, nenin 52-hapja e ofertave, neni 53-shqyrtimi i ofertave, pika 4 e nenit 55-kriteret e përcaktimit të ofertës fitues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar, si dhe pikës 4, shkronjat “a,b,c,ç,d dhe i”, kreu V, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshua, nuk është ndjekur asnjë procedurë shkresore, për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sepse nuk është mbajtur asnjë procesverbal për këtë procedurë.

6. G.S., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtues i Këshillit Teknik, si dhe, në cilësinë e specialistit të Nj.P, në tenderin me objekt ‘Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë’, për vitin 2013, *për mangësi të konstatuara në:*

Hartimin e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike, duke vendosur 2 zëra pune në kundërshtim me kreun II-të, neni 5-mbeturinat, neni 6-përjashtimet, të ligjit nr. 8094, datë 29.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe germës “c”-kontrata shërbimi, pika 3-informacione të veçanta, kreu III-dokumentet e tenderit, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke është shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit me vlerë prej 2,141,129 lekë (me TVSh).

Preventivimin tepër në fond limit në 1 rast në investimin publik “Varrezat Himarë, Faza III”, veprim në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” pika 2, 3 dhe 9, duke shkaktuar rritje fiktive të fondit limit në vlerën 1,932,872 lekë pa tvsh ose me rreth 23.2 % të tij.

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 1 procedurë të marrjes në dorëzim të investimit “Rikonstruksion rrugë të brendshme, Ujësjellës, KUZ, KUB, Ndriçim rrugor, Telefoni Lagja Stefanel” realizuar nga “Salillari” sh.p.k. me dëm ekonomik në vlerën prej **6,082,193 lekë pa tvsh, ose 14.4 % e kontratës**, si pasojë e pagesave të paligjshme dhe të pamerituara, të përfutur nga përlllogaritja dhe likuidimi i punimeve të situacionuara por të pa realizuara në fakt, veprim në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”.

Për marrjen në dorëzim të PPV dhe kalimin e tij për miratim në Këshillin e Bashkisë Himarë me mungesa në formë dhe strukturë ligjore të dokumenteve që shoqërojnë PPV, mungesë të 14 prej 24 hartave që ka një PPV sipas VKM nr. 481, datë 22.06.2011, shtojca 2, ndër të cilat harta mjaft të rëndësishme si ato të bonitetit të tokave bujqësore, të pronave publike apo të problematikës së pronësisë publike dhe private, informacioni i të cilave ndikon drejtpërsëdrejti në propozimin e përdorimit të tokës dhe që në këtë rast nuk marë parasysh, ashtu si nuk janë konsideruar as informacionet që merren prej hartave të tjera analizuere.

Për mungesën e bashkëpunimit dhe këshillimit me AKPT gjatë gjithë procesit të planifikimit dhe miratimit të PPV, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin të Territorit”, të ndryshuar.

Për mosndjekjen e procedurave të nismës për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit dhe mos realizimin e dokumentacionit që shoqëron këtë proces, konform nenit 40 të ligjit të sipërcituar.

Për mospërbushjen e detyrimit ligjor të pajisjes të gjithë territorit në juridiksion të Bashkisë Himarë me instrumente të detajuara vendor brenda 24 muajve nga miratimi i instrumentit të përgjithshëm vendor, konform ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar, neni 45/1, pika 2.

Për shqyrtim dhe miratim në zbatim të PPV, të 4 instrumenteve të jashtëligjshëm, një “Resort me Vila” dhe tre “Masterplane, të cilët nuk përputhen në terminologji, strukturë e format me asnjë nga instrumentet e ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit,” të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Detajuar Vendor Jalë (Njësia strukturore II.3.a, Zonat T.1.1, T.1.2 dhe S2), në kundërshtim me përcaktimet e Plani i Përgjithshëm Vendor për zonën S2. Veprim ky i bërë qëllimisht për ti dhënë mundësinë e legalizimit ndërtimeve ekzistuese pa leje, të konstatuara nga grupi i auditimit gjatë evidentimit në terren të datës 09.10.2014, në këtë zonë, kjo në kundërshtim me VKM nr. 481, datë 22.6.2011 të ndryshuar, neni 21/1, pika 1 dhe 2.

Për miratim të lejeve të zhvillimit pa u shqyrtuar më parë në Këshillin Teknik, për dhënien e lejes së zhvillimit nr.1663 prot., datë 31.10.2013 kompanisë së ndërtimit “ARL Konstruksion” sh.p.k. për objekt lokal shërbimi për zhvillimin e turizmit 1 kat në pronë të Mihal Kallushi, në mungesë të certifikatës së pronësisë apo vërtetimit nga dokument hipotekor, si edhe miratimin e lejeve sipas një formulari jo ligjor, në kundërshtim me VKM nr. 502, datë 13.07.2011, të ndryshuar, *duke mos përmbushur detyrimin e përcaktimit të të dhënave të përgjithshme dhe kondicioneve teknike në leje*. Për paqartësitë dhe mospërputhjet në llogaritjen e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit dhe mosplotësim të të gjitha kërkesat ligjore për dokumentacionin që përmban një leje zhvillimi konform shtojcës 2, formulari Tip. 1, seksioni 8, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011, të ndryshuar.

Për përlllogaritje të gabuar të taksës 4% të lejeve të zhvillimit për shtesat pa leje në objekte me leje si edhe për shqyrtimin e miratimin e kërkesave për këto të fundit pa dokumentin që vërteton pagesën e gjobës konform nenit 82 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “*Për Planifikimin të Territorit*”, të ndryshuar, duke i shkaktuar buxhetit të njësisë vendore një dëm ekonomik në vlerën 10,379,302 lekë, për lejet endërtimit dhe lejet e zhvillimit sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 06.02.2013, dhënë subjekteve: “A..” shpk, leje zhvillimi nr. 1132 prot. datë 05.08.2013, për objekt banimi 4 dhe 5 kate, Spile Himarë, “Rinia 04” shpk, leje zhvillimi nr. 1487 prot. datë 04.10.2013, për objekt banimi 4 kate, Potam Himarë, “Pali” shpk, leje zhvillimi nr. 2 prot. datë 11.07.2013, për objekt hotel 3 kate me dy kate podrum në Dhërmi, dhe “S...” shpk, leje zhvillimi nr. 1120 prot. datë 01.08.2013, në pronën e A.M, për 2 godina banimi 4 kate dhe një kat podrum në Potam.

Për moshartimin e akteve të kontrollit në lidhje me ngritjen e kantierit të punimeve, përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin, përfundimin e fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re përfshirë sistemet e ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik, përfundimin e sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese si dhe regjistrimin e infrastrukturës publike të nevojshme për zhvillimin e zonës, në kundërshtim me nenin 79 pika 2 e ligjit 10 119, datë 23.04.2009 “*Për Planifikimin të Territorit*” të ndryshuar dhe VKM nr. 502, datë 13.07.2011, e ndryshuar, neni 38 pika 2, për 13 banesa 2 kate + papafingo, në pronën e z. K.Zh, Dh.Z, K.Z, U.Z, për subjektin ndërtues “Z...” shpk, në Dhërmi.

Për miratimin e lejes së përdorimit nr. 376 prot. datë 28.03.2013 për objektet e mësipërme në mungesë të relacionit të zbatuesit të punimeve si dhe certifikatës së provave të materialeve të përdorura lëshuar nga laboratorët e përcaktuar, përfundimet e provave të ngarkesës, si dhe dokumentet që vërtetojnë se objekti është zbatuar në përputhje me projektzbatimin, pa shmangie në drejtimet funksionale dhe statike, këto në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” të ndryshuar.

Për shmangien e detyrimit të dërgimit për këto objekte, konform nenit 12/1 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, të kërkesave për regjistrimin e lejes së ndërtimit, regjistrimin e përkohshëm të karabinasë dhe konfirmimin për përfundimin e punimeve të karabinasë.

Për mos kryerjen e detyrës të evidentimit dhe marrjes së informacionit për zhvillimet në territorin që ka nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, në kundërshtim me ligjin nr.10119, datë 23.04.2009 “*Për Planifikimin e*

Territorit”, Seksioni VII “Vëzhgimi, Inspektimi, Kundravajtjet e Dënime”t, neni 80 “Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren”, pika 1 dhe 2.

7. Ll.P, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, në cilësinë e specialistit të Nj.P, në tenderin me objekt ‘Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë’, për vitin 2013, *për mangësi të konstatuara në:*

Hartimin e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike, duke vendosur 2 zëra pune në kundërshtim me kreun II-të, neni 5-mbeturinat, neni 6-përjashtimet, të ligjit nr. 8094, datë 29.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe germës “c”-kontrata shërbimi, pika 3-informacione të veçanta, kreu III-dokumentet e tenderit, të VKM nr. 1, datë 10.01.207 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke është shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit me vlerë prej 2,141,129 lekë (me TVSh).

8. A.P, me detyrë ish-Jurist, në cilësinë e Juristit në Nj.P, në tenderin me objekt ‘Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë’, për vitin 2013, *për mangësi të konstatuara në:*

Hartimin e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike, duke vendosur 2 zëra pune në kundërshtim me kreun II-të, neni 5-mbeturinat, neni 6-përjashtimet, të ligjit nr. 8094, datë 29.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe germës “c”-kontrata shërbimi, pika 3-informacione të veçanta, kreu III-dokumentet e tenderit, të VKM nr. 1, datë 10.01.207 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke është shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit me vlerë prej 4,287,902 lekë (me TVSh).

9. Znj. M. L, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës financës dhe buxhetit, në cilësinë e anëtarit të komisionit për periudhën e 6 mujorit të dytë të viti 2012 dhe Kryetar i Komisionit të Prokurimeve për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, si dhe në cilësinë e specialistet të Nj.P, në tenderin me objekt “Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë”

10. E.R, me detyrë specialiste e nivelit të lartë, në cilësinë specialiste në Nj.P, në cilësinë specialiste në Nj.P, në tenderin me objekt “Pastrim dhe mirëmbajtje varreza, Bashkia Himarë”, për vitin 2014, *për mangësi të konstatuara në:*

Hartimin e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike, duke vendosur 2 zëra pune në kundërshtim me kreun II-të, neni 5-mbeturinat, neni 6-përjashtimet, të ligjit nr. 8094, datë 29.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe germës “c”-kontrata shërbimi, pika 3-informacione të veçanta, kreu III-dokumentet e tenderit, të VKM nr. 1, datë 10.01.207 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke është shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit me vlerë prej 2,146,773 lekë (me TVSh).

11. A.Th, me detyrë specialist i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe anëtar Këshillit Teknik, *për mangësi të konstatuara:*

Për mospërputhjet në llogaritjen e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit dhe mosplotësim të të gjitha kërkesat ligjore për dokumentacionin që përmban një leje zhvillimi konform shtojcës 2, formulari Tip. 1, seksioni 8, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011, të ndryshuar.

Për përlllogaritje të gabuar të taksës 4% të lejeve të ndërtimit dhe lejeve të zhvillimit për shtesat pa leje në objekte me leje, duke i shkaktuar buxhetit të njësisë vendore një dëm ekonomik në vlerën **1,479,964 lekë**, për lejet e ndërtimit dhe lejet e zhvillimit sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 06.02.2013.

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 1 procedurë të marrjes në dorëzim të investimit “*Rikonstrukcion rrugë të brendshme, Ujësjiellës, KUZ, KUB, Ndriçim rrugor, Telefoni Lagja Stefanel*” realizuar nga “S.....” sh.p.k. me dëm ekonomik në vlerën prej 6,082,193 lekë pa tvsh, ose 14.4 % e kontratës, si pasojë e pagesave të paligjshme dhe të pamërituara, të përfutur nga përlllogaritja dhe likuidimi i punimeve të

situacionuara por të pa realizuara në fakt, veprim në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”.

12. A. D, me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor dhe anëtar Këshillit Teknik dhe

13 z. R.B, me detyrë ish-Kryeinspektor INUV, *për mangësi të konstatuara:*

1. Për 74 vendime të pezullimit janë vendosur gjoba në vlerën 1,054,000 lekë, në zbatim të nenit 5 germa b, të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”, si dhe nenin 82, të ligjit nr. 10119 date 23.04.2009 “Planifikimin e Territorit”, por nuk është *kërkuar arkëtimi i tyre, duke krijuar të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë, veprime këto në shkelje te kërkesave te pikës 4 te nenit 30-Arkëtimi I shumave te detyrimeve*, të ligjit nr. 10279 date 20.05.2010 ‘Për kundërvajtjet administrative.

2. Për periudhën nga data 01.01.2012 deri me datë 30.06.2014, nga INUV Bashkia Himarë janë vendosur gjithsejtë 202 gjoba në shumën 33.090.000 lekë, pa u kërkuar arkëtimi i tyre, veprime në kundërshtim me Kreun e V, pika 4 e nenit 30, të ligjit nr. 10279 date 20.05.2010 ‘Për kundërvajtjet administrative”.

3. Për periudhën nga data 01.01.2012 deri ne datë 30.06.2014, kanë dalë vendime prishje për 61 raste nga ku për vitin 2012 nga 23 vendime prishje është ekzekutuar vetëm 1 (një) rast, për vitin 2013 nga 30 vendime prishje nuk është ekzekutuar asnjë dhe për 6/mujorin e parë 2014 nga 8 vendime prishje janë ekzekutuar vetëm 3 raste.

4. Nga INUV Bashkia Himarë janë bërë vetëm 5 kallëzime penale, për ndërtime pa leje, veprime këto qe bien në kundërshtim me neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, dhe nenin 5 “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

5. Për lejimin e ngritjes së ndërtimeve të kundraligjshme dhe mosveprimit ndaj ndërtimeve të kundraligjshme ekzistuese për 14 raste, në një zonë të rëndësisë kombëtare, siç është zona bregdetare e përfshirë në territorin e Bashkisë Himarë, duke sjellë kështu dëme përsa i përket zhvillimit të këtyre zonave, konform instrumenteve dhe politikave planifikuese, në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, të ndryshuar, neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, si dhe në kundërshtim të plotë me nenin 5 të këtij ligji “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”.

6. Për mos shoqërim konform ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, të masave të marra për ndërtimet pa leje me vendimeve për Prishjen e Ndërtimeve të Kundraligjshme, Informimin e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, përgatitjen e Kallëzimit Penal për kundravajtësin, paraqitje pranë organeve përkatëse të kërkesës për heqje të licencës profesionale ose të shoqërisë, për objekt pa leje në Potam, në pronësi të P. B, objekt pa leje në Drimadhë, në pronësi të S.K dhe 4 objekte pa leje në Jalë, në pronësi të F... M....

7. Për mos vendosjen dhe vjeljen e gjobave konform nenit 82 dhe 83 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “për Planifikimin të Territorit”, të ndryshuar dhe shkaktimit të dëmit ekonomik në buxhetin e njësisë vendore në vlerën 8,899,338 lekë, për shtesat pa leje në 4 objektet me leje:

D.1 MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,

ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), Pika I-Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, *i rekomandojmë Komisionit të dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksion “Heqje e Licencës, për një afat prej 1-2 vjet”, për H.Gj, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, pasi ka:*

Kryer kolaudim të punime me volume pune të pakryera në objektin “*Rikonstrukcion rrugë të brendshme, Ujësjiellës, KUZ, KUB, Ndriçim rrugor, Telefoni Lagja Stefanel*”, realizuar nga “Salillari” sh.p.k., veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, neni 7 dhe 12 dhe udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” e konkretisht Kreu II, Pika 3, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore në vlerën prej **6,082,193 lekë pa tvsh, ose 14.4 % e kontratës**, si më poshtë:

Për zërat *Struktura monolite betoni C 12/15* dhe *Struktura monolite betoni C 16/20* situacioni përfundimtar paraqet për këta dy zëra përkatësisht çmimin 7,800 lekë/m³ dhe 9,800 lekë/m³ kur në fakt sipas VKM nr. 407, datë 27.6.2012, *Punime betoni e betonarmeje*, në zërat nr. 9 dhe nr. 10 me nr. analize përkatësisht 3.242 *Struktura monolite betoni C 12/15* dhe 3.243 *Struktura monolite betoni C 16/20*, rezulton se në analizën e çmimit është përfshirë edhe vlera e kallëpeve për njësinë 1 m³ beton C 12/15 dhe C 16/20. Sipas preventivit dhe situacionit përfundimtar rezulton të jetë preventivuar, librezuar dhe situacionuar zëri nr. 11, *Punime skelerie dhe kallëpi, Kallëp me panele druri për pila e ballna e mure*, duke përsëritur kështu volumin e punës për elementin “kallëpe”, duke përfituar më tepër diferencën 1,928 lekë/m³ për 1470 m² për këto dy zëra, ku 1,928 lekë/m³ është vlera e kallëpit të përdorur për 1 m³ beton;

Diferenca në volume pune të pakryera për zërin *Struktura monolite betoni C 12/15* në masën 51.81 m³ si pasojë e mos respektimit të detajeve të projektit;

Diferenca në volume pune të pakryera për zërin *Struktura monolite betoni C 16/20* në masën 131.2 m³ si pasojë e mos respektimit të detajeve të projektit;

Diferenca në volume për zërin *Transport betoni me auto betoniere 3.0 km* në masën 183 m³ si pasojë e volumeve të pakryera në zërat *Struktura monolite betoni C 12/15* dhe *Struktura monolite betoni C 16/20*;

Diferenca në volume pune të pakryera për zërin *F.V hekur të zakonshëm* në masën 2.71 ton si pasojë e rritjes fiktive të peshave të shufrave të hekurit për ml;

Diferenca në volume pune të pakryera për zërin *Shtresë asfaltbetoni me granil, 4 cm, me makineri* i cili rezultoi i pakryer në masën 100 %, ose 1,109 m²;

Diferenca në volume për zërin *Shtresë binderi me gur kave, 6 cm, me makineri* në masën 45 m²;

Diferenca në volume për zërin *Gërmim shkëmbi për tubat* në masën 89 m³;

Mangësi në dokumentacion në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”.

D/II. Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.06.2000, **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 10 anëtarët e Komisionit Vlerësimit të Ofertave dhe 6 anëtarë të Njësisë së Prokurimit.

Procedurat e prokurimit të kryera nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë, në të cilat punonjësit e sipërcituar kanë qenë të ngarkuar me detyrën e Anëtarët të Komisionit Vlerësimit të Ofertave dhe Njesisë së Prokurimit, janë si më poshtë:

1. “Rikonstruksion rrugë të brendshme, Ujësjiellës, KUZ, KUB, Ndriçim rrugor, Telefoni, lagja Stefanel”, viti 2012
2. “Rikonstruksion i stadiumit Vetëtima”, viti 2012
3. “Ndërtimi i Varrezave”, viti 2012
4. “Rikonstruksion rrugë të brendshme, “Rehabilitim i rrugës Qeparo-Fushë Qeparo Fshat”, viti 2012
5. “Blerje kazanë për mbeturina”, viti 2012
6. “Ujësjiellësi në Himarën e vjetër, depo në kala, pusi në livadh”, viti 2013
7. “Spostimi i linjës së ujësjiellësit në fshatin Vuno”, viti 2013
8. “Shëtitoret buzë detit”, viti 2014
9. “Rruga Gjilekë”, viti 2014
10. “Spostim linjash uji -Vuno”, viti 2014

Nga Bashkia Himarë, me shkresë nr. 481/2, prot, datë 01.04.2015, protokolluar në KLSH me nr.770/25 datë 07.04.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Kristaq Gjurgjaj, Ramadan Zenuni, Ryisin Xhaja, Enejda Serja dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT